

RAPORT
I Vlerësimit të Jashtëm Periodik
Për Programin e studimit MSc në “Farmaci”
Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asc Entela HALOCI

Prof.Asc. Brunilda MYFTARI

Two handwritten signatures in blue ink are positioned to the right of the names. The top signature is for Prof. Asc. Entela Haloci, and the bottom signature is for Prof. Asc. Brunilda Myftari.

(Dhjetor/2017)


RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit MSc në “Farmaci ”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Mjekësore
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhëri i Organizimit	Vendim të MAS. nr.5663 prot, datë.01.09.2005 Urdhër Nr.226, datë 21.07.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 462, datë14.10.2010
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në Farmaci
6	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Institucioni
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Aktivizimi i programit të studimit	2005-2006
17	Numri i studentëve	1087 *

* Ky është numri total i studentëve të regjistruar në këtë program që nga viti akademik 2010-2011 deri në vitin akademik 2017-2018.

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci”

Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University” u licensua me vendim të MASH, Nr. 5663 prot, datë.01/09/2005 si një cikël studimi unik 4-vjeçar (240 kredite).

Në vitin akademik 2008-2009 ky program studimi u riorganizua me Urdhër të MASH Nr.226, dt. 21.07.2009 me të cilin u kalua nga një cikël studimi 4 vjeçar në një cikël studimi 5 vjeçar i integruar (300 kredite). Programi i Studimit aktualisht ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti fiton titullin “Master i Shkencave” në “Farmaci” për Republikën e Shqipërisë.

Programi i studimit është akredituar me Urdhër të MAS nr. 462, datë 14.10.2010 në përputhje me Vendimin nr. 91 Dt 03.09.2010, të Këshillit të Akreditimit me vlerësim pozitiv me disa rekomandime. Institucioni është në vitin e 12-të të diplomimit të studentëve të këtij programi studimi.

Programi i studimit në “Master i Shkencave” në “Farmaci” është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të arsimit me qëllim përgatitjen e profesionistëve të aftë për gjithë sektorët përkatës të zinxhirit shëndetësor.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Entela HALOCI
2. Brunilda MYFTARI

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm është dërguar në Universitetin Privat “Albanian University” me shkresë Nr. 230/11 prot, datë 20.11.2017 “dërgohen Draft raportet e vlerësimit të jashtëm”, dhe nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL.

Institucioni paraqet me shkresë nr. 320 prot, datë 01.12.2017 “Kthim përgjigje për draft raportin e programit të studimit MSc në “Farmaci”, si dhe nëpërmjet sistemit AMS, disa komente dhe sugjerime për draft raportin. Ekspertët e vlerësimit të jashtëm pasi shqyrtuan me kujdes argumentat mbi draft-RVJ, konkluduan se këto argumenta nuk qëndronin. Për këtë arsye raporti nuk ndryshoi. GVJ thekson se në përgjigjen e sjellë nga insitucioni ka shkelje të etikës së komunikimit zyrtar duke dhënë gjykime jashtë kompetencave. Pas kësaj faze raporti mori formën përfundimtare.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit mbi VKA nr. 91 Dt 03.09.2010

1. Të ndryshohet emërtimi i Fakultetit, nga Fakulteti i Stomatologjisë (ku brenda tij ka programin e studimit të Farmacisë dhe të Stomatologjisë) në një emërtim, që i përshtatet të dyja programeve të studimit.

2. Të rritet ngarkesa mësimore e mbuluar nga pedagogët e brendshëm si dhe kualifikimin shkencor në përputhje edhe me orientimet e MASH.
3. Rishikimin e ngarkesës për lëndët e formimit bazë të planit mësimor, duke e reduktuar numrin e krediteve dhe duke balancuar nga ana tjetër me lëndët e kategorisë karakterizuese.
4. Përmirësimin e veprimtarisë shkencore, strukturimin më të mirë të saj me një plan afatgjatë si dhe bashkëpunimin me institucionet jashtë Departamentit të Farmacisë së “Ufo University” të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e kësaj veprimtarie. Të shihet mundësia e angazhimit edhe të studentëve në punimet shkencore.
5. Në përfundim të studimeve të parashikohet një tezë diplome me më shumë kredite se ato të parashikuara në këtë plan studimi për “përgatitjen e provimeve të diplomës”.
6. Të organizohet sa më shpejt përfaqësimi dhe organizimi i studentëve në organizmat studentore dhe organet akademike.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin “Të ndryshohet emërtimi i Fakultetit, nga Fakulteti i Stomatologjisë (ku brenda tij ka programin e studimit të Farmacisë dhe të Stomatologjisë) në një emërtim që i përshtatet të dyja programeve të studimit” institucioni ka kryer riorganizimin e tij dhe **ka ndryshuar** emërtimin me urdhër nr. 196, dt. 28.05.2013 **Ky rekomandim është plotësuar.**
- b) Për rekomandimin “Të rritet ngarkesa mësimore e mbuluar nga pedagogët e brendshëm si dhe kualifikimin shkencor në përputhje edhe me orientimet e MASH”:

Institucioni :

- Ka rritur numrin e stafit akademik me kohë të plotë me grada dhe tituj akademik, por jo me ngarkesë të plotë siç parashikohet në **Udhëzimin 20. 20.4.2008** (të cilin institucioni deklaroi se zbaton). Ngarkesa e stafit akademik me kohë të plotë luhet për dy vitet e fundit akademik nga 45-420

(Tabela 1)

- Nuk ka asnjë akt normativ të brendshëm për shpërndarjen e ngarkesave në përputhje me titujt akademik dhe pozicionet administrative.

Tabela 1. Ngarkesa mesimore minimale dhe maksimale

Viti Akademik	Luhatje e ngarkesës mesimore vjetore për PAE
2015-2016	45-430 orë
2016-2017	30-420 orë
2017-2018 semestri I	15-270 orë

- Raporti i numrit staf akademik me kohë të plotë /staf akademik me kohë të pjesshme në lidhje me këtë program studimi prej vitit 2010 e vazhdim është jo në përputhje me **Udhëzimin MASH nr 11. Dt 28.2.2011 Shtojca 2 pika 20. (Tabela 2)**

Tabela 2. Raporti PAE/PAK sipas viteve akademike

Viti Akademik	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK	% PAE/ %PAK	Udhëzimin MASH nr 11. Dt 28.2.2011 Shtojca 2 pika 20 - 70/30 %
2010-2011	15	53	15/53	22%/78%	Nuk plotësohet
2011-2012	13	64	13/64	17%/83%	Nuk plotësohet

2012-2013	8	68	8/68	10%/90%	Nuk plotësohet
2013-2014	19	57	19/57	25%/75%	Nuk plotësohet
2014-2015	25	60	25/60	30%/70%	Nuk plotësohet
2015-2016	32	52	32/52	40%/60%	Nuk plotësohet
2016-2017	30	28	30/28	52%/48%	Nuk plotësohet
2017-2018 semestri I	29	14	29/14	67%/ 33%	Nuk është e plotë

- Një pedagog realizon ngarkesë mësimore në disa lëndë të ndryshme ndonjëherë edhe jo të të njëjtit karakter duke përguar profilizimin e stafit akademik.
- Realizimi i ngarkesës mësimore për këtë program studimi nga personeli akademik efektiv bazuar në **Udhëzimin MASH nr 11. Dt 28.2.2011 Shtojca 2 pika 5, plotësohet për vitet akademike 2015- 2016 dhe 2016-2017 (Tabela 3)**

Tabela 3. Raporti i ngarkesës mesimore PAE/PAK sipas viteve akademike

Viti Akademik	Ngarkese mesimore PAE	Ngarkese mesimore PAK	PAE/ PAK %	Udhëzimin MASH nr 11. Dt 28.2.2011 Shtojca 2 pika 5 70/30 %
2015-2016	5984	1410	80%/20%	Plotësohet
2016-2017	5659	2468	69.63/30.36	Plotësohet

Ky rekomandim plotësohet pjesërisht

- c) Për rekomandimin “*Rishikimin e ngarkesës për lëndët e formimit bazë të planit mësimor, duke e reduktuar numrin e krediteve dhe duke balancuar nga ana tjetër me lëndët e kategorisë karakterizuese, institucioni ka riklasifikuar lëndë të caktuara nga një kategori në tjetrën dhe ka akoma pasaktësi.*”

Klasifikimi sipas disiplinave A,B,C,D,E,F ndryshon nga ai paraqitur në RVB për vitin akademik 2015-2016 dhe atij të paraqitur për vitin akademik 2016-2017 paraqitur si ankes shtesë i RVB. Ndryshime vihen re dhe në rregulloren e programit të studimit. (p.sh. lëndët Biokimi, Biofarmaci, Tema e diplomës etj). Institucioni gjithashtu në planin mësimor të riorganizuar ka bërë ndryshime të rëndësishme të krediteve të pothuajse të të gjitha lëndëve të programit të licensuar.

Vlen të përmendim se referuar tabelës së mëposhtme në planin mësimor të riorganizuar janë shtuar kreditet e lëndëve të përgjithshme dhe janë pakësuar kreditet e lëndëve karakterizuese në kundërshtim me rekomandimin e lënë. Gjithashtu nga 5 kategoritë e lëndëve kriteri ligjor në përqindje plotësohet vetëm në 2 prej tyre.

Veprimtaria	PLANI MESIMOR			Kriteri sipas udhëzimit 15 dt 4.4. 2008 Cikli I dyte I integruar	Realizimi
	2015-2016 I vjeter sipas RVB	2016-2017 I ri- sipas rregullores te programit)	2016-2017 sipas aneksit rvb 16-17 *		
A- Disiplina te pergjithshme	75 – 25%	78 – 26%	74.5 - 25%	Rreth 15 % (45 kredite)	Shume i larte. Edhe ne planin mesimor te rishikuar jane rritur akoma me shume lendet e formimit te pergjithshem jo ne perputhje me rekomandimin e lene. – ESHTE PERKEQESUAR

B- Disiplina karakterizues e te programit	153 – 51%	135 – 45%	149.5 - 51%	Rreth 45 % (135 kredite)	Plotesohet
C- Disiplina integruese	32 – 10.6%	40 – 13.3%	34 – 11 %	Rreth 10 % (30 kredite)	Jane rritur kreditet per disiplinat integruese – NUK KA QENE E NEVOJSHME.
D- Disiplina te zgjedhuar nga student	0 – 0 %	4 – 13.3 %	-	Rreth 7-8% (21-24 kredite)	Jane vendosur por ne % mjaft te ulet - DUHEJ TE PERMIRESOHEJ
E- Informatike, gjuhë e huaj , Praktike	30 – 30.0 %	33 – 11 %	28 – 9.3%	Rreth 10 % (30 kredite)	Plotesohet
F- Diploma	10 – 3%	10 – 3%	10 – 3%	Rreth (7-14 %) (20- 40 kredite)	E ulet – DUHEJ TE PERMIRESOHEJ

**shenim. Tek kjo tabelë lenda biofizike është perseritur 2 here , si dhe mungojë lende pasi totali i krediteve është 296 jo 300 . Ky rekomandim nuk plotësohet*

- d) Për rekomandimin “Përmirësimin e veprimtarisë shkencore, strukturimi më i mirë i saj me një plan afatgjatë si dhe bashkëpunimin me institucionet jashtë Departamentit të Farmacisë së “Ufo University”, të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e kësaj veprimtarie. Të shihet mundësia e angazhimit dhe të studentëve në punimet shkencore”.

Institucioni ka realizuar dy marrëveshje në lidhje me programin e studimit si dhe ka filluar të përfshijë studentët në punimet shkencore, megjithatë mbetet ende shumë punë për të bërë për të arritur standartet dhe kriteret përkatëse.

Ky rekomandim plotësohet pjesërisht

- e) Për rekomandimin “Në përfundim të studimeve të parashikohet një tezë diplome me më shumë kredite se ato të parashikuara në këtë plan studimi për “përgatitjen e provimeve të diplomës”

Gjatë gjithë viteve akademike nga 2010 deri në 2017 ky rregullim nuk është reflektuar. Plani mësimor në fuqi i përmirësuar në tetor 2015 ende nuk i ka kreditet e veprimtarisë “temë diplome” në përputhje me **udhëzimin nr 15 dt. 04.04.2008**. Për më shumë institucioni ende edhe në vitin akademik 2016-2017 vazhdon të diplomojë studentët e këtij programi studimi kryesisht me provim diplomimi jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Ky rekomandim nuk plotësohet

- f) Për rekomandimin “Të organizohet sa më shpejt përfaqësimi dhe organizimi i studentëve në organizmat studentore dhe organet akademike”.

Institucioni ka krijuar senatin studentor me përfaqësuesit nga secili kurs studimi. Studentët ende nuk janë të përfshirë dhe përfaqësuar në organet kolegjiale akademike dhe këshillat e fakultetit.

Ky rekomandim plotësohet pjesërisht.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Misioni dhe qëllimi i institucionit “Albanian University” siç theksohet në statutin e tij është të krijojë profesionistë të aftë në fushat përkatëse të studimeve që ai ofron. Edhe programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” në përputhje me këtë mision ka si objektiv të tij formimin e liderve të aftë që të drejtojnë e menaxhojnë shërbimin farmaceutik.

GVJ sugjeron që theksi i objektivave të programit të studimit duhet të zgjerohet dhe të përfshijë edhe objektiva që kanë të bëjnë me formimin e profesionistëve të aftë që kontribuojnë në radhë të parë në fushën e shërbimit farmaceutik, në shërbimin profesional ndaj pacientëve, gjë që do të përputhej më shumë me programin mësimor që ofrohet nga Institucioni.

“Albanian University” në strategjinë e tij afagjatë ka të theksuar zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, por realisht në lidhje me përmirësimin dhe rekomandimet e lëna nga KA në vitin 2010 puna ka filluar vetëm në vitin akademik 2015-2016, në periudhën e aplikimit për riakreditim të keij programi studimi.

Theksojmë se programi studimor pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” në “Farmaci” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, i cili theksohet në statutin e universitetit për të krijuar profesionistë të aftë për profesionin e farmacistit, gjithësesi <i>duhet të saktësohen me qartë në lidhje me produktin final të programit të studimit.</i></p> <p>GVJ sugjeron që theksi i objektivave të programit të studimit duhet të zgjerohet dhe të përfshijë edhe objektiva që kanë të bëjnë me formimin e profesionist të aftë që kontribuojnë në radhë të parë në fushën e shërbimit farmaceutik, në shërbimin profesional ndaj pacientëve, gjë që do të përputhej më shumë me programin mësimor që ofrohet nga Institucioni</p> <p>Ndërkohë institucioni ka ndërmarrë dhe realizuar një studim të tregut të punës gjatë vitit akademik 2016-2017, në të cilin ka arritur në konkluzionin se tregu i punës është i ngopur me profesionistë të fushës së farmacisë. Pavarësisht kësaj institucioni gjatë vizitës ka theksuar se ky konkluzion nuk ndikon në propozimin e kuotave të pranimit për këtë program studimi dhe kanë propozuar në vitet e fundit të njëjtin numër kuotash pranimi. Kjo situatë mund të sjellë konfuzion dhe deri diku papunësi të studentëve të diplomuar, gjë që çon edhe në dëmtim të figurës së farmacistit por edhe cvlerësim të tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit ruan në tërësi vlerat kulturore të kombit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të	

institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi i studimit “Master i shkencave” në “Farmaci” është hartuar në përputhje me strategjinë afatgjatë për zhvillimin e institucionit.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Në ndërtimin dhe përmbajtjen e programit të studimit janë bërë përpjekje për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga akreditimi paraardhës por ende ka disa mangësi dhe mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Programi dhe plani mësimor janë përmirësuar dhe miratuar në tetor 2015 në kuadër të rekomandimeve të lëna nga akreditimi i parë. Planet mësimore me ndryshimet përkatëse kanë hyrë në zbatim vetëm për ciklin e studentëve 2016-2021, ciklet e tjera vazhdojnë me planin mësimor e mëparshëm.</p> <p>Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore edhe në planin mësimor të përmirësuar rezultojnë disa mospërputhje si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Programi i studimit është i ndërtuar vetëm me lëndë, nuk ka module përbërëse duke cuar në lëndë me sasi të lartë kreditesh si p.sh.: Kimi Organike me 14 kredite, Kimi Analitike me 14 kredite, Kimi Farmaceutike I me 12 kredite etj., gjë që çon në penalizim të ecurisë së studimeve të studentëve në vitet e mesiperme apo edhe në mobilitetin e tyre. Në qoftë se këto lëndë do të organizohen në module studentët kanë mundësi të fitojnë një pjesë të krediteve, duke mos i penguar për kalueshmërinë në vite, por edhe për mobilitetin e tyre jashtë universitetit.</i> ➤ <i>Koeficientët e përdorur për të konvertuar kreditet e secilës veprimtari mësimore në orë mësimore dhe raportet midis vetë veprimtarive formuese nuk janë respektuar sipas udhëzimeve përkatëse të MAS p.sh.: seminarët herë llogariten me 10 orë - 15 orë për 1 kredit (kriteri është 6-8 orë), laboratorët luhaten nga 15 orë -17 për 1 kredit (kriteri është 18-25 orë).</i> ➤ <i>Lëndët me zgjedhje janë në përqindje të ulët rreth 4 kredite, nga 20-24 kredite që është kriteri ligjor.</i> ➤ <i>Tema e diplomes është diku 10 kredite dhe diku 15 kredite , por jashtë limiteve referuar udhezimit perkates (kriteri është rreth 20-30 kredite)</i> ➤ <i>Shpërndarja e lëndëve sipas tipologjisë A, B, C, D, E, F shpesh është e pasaktë dhe në dokumentacione të ndryshme nuk është konsistene. Kështu p.sh.: lënda Biokimi, e cila është lëndë me karakter të përgjithshëm,</i>

klasifikohet si lëndë karakterizuese e programit. Lënda Fiziologji, e cila është lëndë integruese e programit është klasifikuar si lëndë me karakter të përgjithshëm. Ky klasifikim i dërguar nga institucioni për vitin akademik 2016-2017 nuk përputhet me atë të paraqitur në rregulloren e programit (miratuar në tetor 2016), tek e cila janë rregulluar një pjesë e lëndëve.

Aktivitetet e tipit C, D, E, F gjithashtu nuk janë në përputhje me përqindjet normative ligjore. Psh përqindja e lëndëve me zgjedhje etj. Në planin mesimor të riorganizuar janë shtuar kreditet e lendeve të përgjithshme dhe janë ulur kreditet e lendeve karakterizuese.

- Nuk pasqyrohet ngarkesa mesimore vjetore dhe ajo javore për studentin në planin mesimor. Nga llogaritjet ajo luhet brenda normave 20-25 orë në javë.
- Në planin mesimor nuk ka të evidentuar aktivitete mesimore në formën e projekteve.
- Në vitin e tretë, të katërt dhe të pestë në planin mesimor të rishikuar 2016-2017 leksionet të llogaritura në % përbëjnë më pak se 50% të totalit (**kriteri ligjor është 50-85%**, Udhëzimi 15, Dt. 4.4.2008). Ky raport vërehet edhe në **tabelen 13** e orëve totale të programit të studimit

Emërtimi i diplomës pavarësisht emërtimit të saktë në dokumentin e hapjes dhe licensimit të programit studimor në dokumentacione të ndryshme të paraqitura nga institucioni (Suplement Diplome, Regjistër i amzës, Rregullore Fakulteti, Rregullore e programit studimor, etj) paraqitet me emërtimin DIND ose cikël 4-vjeçar.

Emërtimi i programit në dokumentin e akreditimit është në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit.

Institucioni ka pasur për detyrë të plotësojë rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë në lidhje me plan-programin e studimit, ka marrë masa dhe ka ngritur grup pune 5 vjet pas akreditimit të parë.

Emërtimi i programit të studimit ka ndryshuar në përputhje me ndryshimet ligjore dhe me urdhrat përkatës të MAS, dhe është në përputhje me nivelin në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit.

Institucioni në dokumentacionet dhe komunikatat e brendshme shpeshherë përdor termin e Master Shkencor në vend të Master i Shkencave, ose termin degë në vend të program studimi. Terminologjia e përdorur duhet riparë edhe në syllabuse dhe komunikimin e brendshëm të institucionit. Kjo gjë vihet re edhe në RVB.

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Institucioni në strategjinë e tij afagjatë ka të theksuar zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, por realisht në lidhje me përmirësimin dhe vënien në jetë të rekomandimeve në lidhje me këtë pikë ka vepruar në momentin e aplikimit për riakreditim.

Universiteti vlerëson për çdo vit akademik mësimdhënien nëpërmjet Raportit Vjetor të realizimit të ngarkesës, si dhe të performancës së stafit akademik.

Konkluzionet e vlerësimit:

- Bazuar në RVB si dhe bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentet shtesë të përftuara gjatë vizitës, GVJ vlerëson se programi i studimit “Master i shkencave” në “Farmaci” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, i cili theksohet në statutin e universitetit për të krijuar profesionistë të aftë për profesionin e farmacistit. *Gjithësesi duhen marrë masa për vënien e objektivave më të qartë, më të lidhur me situatën aktuale të tregut të punës.*
- *Ndërtimi dhe përmbajtja e programit të studimit ka mospërputhje me aktet dhe nënaktet ligjore përkatëse si dhe me rekomandimet e lena.*
- *Në planin mësimor të riorganizuar lëndët karakterizuese janë zvogëluar dhe janë rritur kreditet e disiplinave të formimit të përgjithshëm dhe integruese.*
- Emërtimi i programit në dokumentin e akreditimit është në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit.
- Emërtimi i diplomës është i saktë në dokumentin e hapjes dhe licensimit të programit studimor. *Në Formatin e diplomës thuhet që studenti ka mbrojtur tezën e diplomës ndërkohë në suplementin e diplomës janë vendosur provime formimi.*
- Terminologjia e përdorur gjatë komunikimeve të brendshme të institucionit si dhe dokumentacionit të paraqitur duhet të jetë e saktë dhe konseguente.
- Vlen të theksohet se institucioni në strategjinë e tij afagjatë ka të theksuar zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Albanian University përbëhet nga strukturat akademike dhe administrative. Sipas organigramës, Autoritetet drejtuese janë Rektori, Dekani, Përgjegjësi i departamentit dhe administratori; Organet kolegjiale drejtuese janë Senati akademik, Këshilli i Fakultetit, Këshilli i Etikës. Sipas Urdhërit të MAS Nr. 52 dt. 05.02.2016 Universiteti Privat “Albanian University” është riorganizuar në tre njësi kryesore konkretisht:

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore
2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga më shumë se tre Departamente dhe çdo departament ka më shumë se 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët minimumi 3 me gradë/titull akademik. Në Dhjetor 2016 insitucioni ka hartuar edhe statutin e ri në përputhje me Ligjin e ri nr. 80/2015 dt 22.07.2015 të Arsimit të Lartë.

Në kuadër të rekomandimeve të akreditimit të parë institucioni është riorganizuar me Urdhër të MASH Nr. 196, Dt.28.05.2013 sipas të cilit Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga:

1. Departament i Stomatologjisë,
2. Departamenti i Farmacisë,
3. Departamenti i Fizioterapisë dhe Infermerisë
4. Klinika universitare
5. Qendër kërkimore

Në RVB, në Rregulloren e Universitetit, në Rregulloren e Fakultetit dhe në disa akte të tjera të brendshme organigrama nuk përputhet me këtë urdhër, por shfaqet thjesht me tre departamente me ose pa klinikën universitare.

Njësia shërben si bazë e realizimit, monitorimit dhe vlerësimit të procesit mësimor. Ajo merr pjesë direkt në këto procese dhe përcjell mendimet nëpërmjet përfaqësuesve të vet në hallkat akademike dhe administrative. Përgjegjës për këto procese është drejtuesi i departamentit, i cili dhe ruan database-in e të dhënave të departamentit.

- *Rregullorja e Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" është miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit jo në përputhje me Statutin, ku thuhet se miratohet nga titullari i Njesisë Kryesore.*
- *Gjatë vizitës në institucion u konstatua se në regjistrin themeltar për çdo gjeneratë në përfundim të saj vendoset një vijë e kuqe, por jo gjithmonë ka firmë dhe vulë të personit përgjegjës nga institucioni në lidhje me këtë procedurë sic specifikohet në udhezimet e regjistrimeve për çdo vit akademik.*

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga më shumë se tre Departamente dhe çdo departament ka më shumë se 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët minimumi 3 me gradë/titull akademik. (Tabela 4)

- Departamenti i Farmacisë

a) Për vitin akademik 2016-2017 sipas RVB Departamenti përbëhet nga **30** personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; **1** –Prof.Dr, **2**-Prof.Asc, **16**-Dr dhe **11**-Msc, ndërkohë që në dokumentacionin që u kërkuar gjatë vizitës stafi u paraqit me një total prej **24** personel akademik efektiv(PAE) nga të cilët **2**-Prof.Asc, **12**-Dr, **10**-Msc.

b) Për vitin akademik 2015-2016 sipas RVB Departamenti përbëhet nga **32** personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët **11** –Dr dhe **21** – Msc.

d) Per vitin akademik 2014-2015 sipas RVB Departamenti përbëhet nga **25** personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët **6**-Dr dhe **19**-Msc

e) Për vitin akademik 2013-2014 sipas RVB Departamenti përbëhet nga **19** personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët **1**-Prof.Asc **3**-Dr dhe **15**-Msc

f) Për vitin akademik 2012-2013 sipas RVB Departamenti përbëhet nga **7** personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët **2**-Prof.Dr dhe **5**-Msc

- Departamenti i Stomatologjise

Për vitin akademik 2016-2017 Departamenti përbëhet nga një total prej **35** vetash nga të cilët **2**-Prof.Dr, **1**-Prof.Asc, **8** –Dr, **6** SPA, **4**PhD dhe **14** –Msc.

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë

Për vitin akademik 2016-2017 Departamenti ka një total prej 39 vetash nga të cilët; 1 –Prof.Dr, 1-Prof.Asc, 11-Dr, dhe 26 –Msc.

Vihe re se për vitin akademik 2016-2017 stafi akademik me tituj dhe grada është rritur në krahasim me atë të vitit akademik të mëparshëm. Ka pasur një përmirësim të vazhdueshëm në rritje të stafit akademik me grada dhe tituj.

Shënim. Për vitin akademik 2016-2017 insitucioni ka paraqitur dy lista të ndryshme të personelit akademik efektiv për departamentin e farmacisë, një listë sipas RVB me 30 persona dhe një listë mbas vizitës me 24 persona.

Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet

Sipas organigramës, Autoritetet drejtuese të Universitetit janë Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit dhe Administratori; Organet kolegjiale drejtuese janë Senati akademik, Këshilli i Fakultetit, Këshilli i Etikës. Kompetencat e Organeve të zgjedhura përkruhen në Statut.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ u kërkua Urdhri për miratimin e riorganizimit të Institucionit si dhe Përbërja e stafit akademik të Fakulteti të Shkencave Mjekësore sipas departamenteve. Institucioni dërgoi në rrugë zyrtare të gjithë urdhrat e riorganizimit, Urdherin Nr.52 dt 05.02.2016

Ndër ta veçojmë Urdhërin e MASH Nr. 196 Dt. 28.05.2013 që sanksionon se Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga:

1. Departamenti i Stomatologjisë,
2. Departamenti i Farmacisë,
3. Departamenti i Fizioterapisë dhe infermerisë
4. Klinika universitare
5. Qendër kërkimore

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij; Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete; Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente; Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar; Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".	Në vitin akademik 2012 -2013 insitucioni është riorganizuar me urdhër nr 196 dt 28.5.2013 ku Fakulteti iShkencave Mjekësore përbëhej nga: 1. Departament i Stomatologjisë, 2. Departamenti i Farmacisë, 3. Departamenti i Fizioterapisë dhe Infermerisë 4. Klinika universitare 5. Qendër Kërkimore <i>Per vitet akademik 2012 – 2017 organigrama e pasqyruar në Statut, rregullore insitucionale dhe Rvb nuk përputhet me urdhërin e riorganizmit nr 196 dt 28.5.2013 . Paraqitet pa qendrën kerkimore.</i> Për vitin akademik 2017- vazhdim Institucioni aktualisht është organizuar në përputhje me kriteret

	<p>ligjore ne fuqi. Sipas urdhërit të MAS Nr. 52 dt. 05.02.2016 Universiteti Privat “Albanian University” është riorganizuar në tre njësi kryesore konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore 2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore 3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike <p>Kete riorganizim e ka pasqyruar edhe në statuin e ri .</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka në përbërje më shumë se tre Departamente dhe çdo departament ka më shumë se 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët minimumi 3 me gradë/titull akademik.</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017 sipas RVB, departamenti i farmacisë përbëhet nga 30 staf akademik efektiv (PAE) nga të cilët 1 –Prof.Dr, 2- Prof.Asc, 16-Dr dhe 11-Msc, ndërkohë që gjatë vizitës nga insitucioni u paraqit dokumentacion me një total prej 24 staf akademik efektiv (PAE),nga të cilët 2-Prof.Asc, 12-Dr, 10-Msc.</p> <p>Për vitin akademik 2015-2016 sipas RVB, Departamenti përbëhet nga 32 staf akademikefektiv (PAE) nga të cilët 11 –Dr dhe 21 – Msc.</p> <p>Vihet re se në vitin akademik 2016-2017 krahasuar me atë 2015-2016 është rritur numri i stafit akademik me grada e tituj. Gjithashtu vihet re një përmirësim nga viti akademik 2010 e në vazhdim në lidhje me rritjen e numrit të stafit akademik me grada dhe tituj.</p>
--	--

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë angazhohen drejtpërdrejtë me përgjegjshmëri në realizimin e programit të studimit siç janë propozimi i kuotave, parashikimi i ngarkesës, propozime për ndryshime kurrikulare, raport vjetor në lidhje me aspektet akademike dhe organizative në nivel programi studimi, propozim për rekrutimin e stafit etj.</p> <p>Njësitë bazë realizojnë vlerësimin e stafit akademik nëpërmjet kriterëve dhe standarteve të përshkruara në formularin përkatës, i cili plotësohet për çdo pedagog dhe vendoset në dosjen personale, e cila arkivohet në departament.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

- Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vlerëson se AU në përgjithësi dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore në veçanti janë të organizuara në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Departamenti i Farmacisë përbëhet nga më shumë se 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët minimumi 3 me gradë/titull akademik. Përbërja e departamentit të Farmacisë për vitin akademik 2016-2017 paraqitet e ndryshme (24) gjatë vizitës krahasuar me atë të deklaruar në RVB. (30). Vihet re në vitin akademik 2016-2017 krahasuar me atë 2015-2016 dhe me parë në të cilat është

rritur numri i stafi akademik me Titull Prof.Dr, Prof.Asc dhe është zvogëluar numri i stafit me titullin Msc

- GVJ vlerëson se organigrama e deklaruar në RVB, si dhe në dokumentat e dorëzuara si Rregullore e Universitetit, Rregullore e Fakultetit dhe disa akte të tjera të brendshme, *ku thuhet se F.Sh.M. përbëhet nga vetëm tre departamente, nuk përputhet me Urdhrin e MAS Nr.196, Dt. 28.05.2013 për miratimin e riorganizimit, ku F.Sh.M. përbëhet nga tre departamente, klinika universitare dhe qender kerkimore*
- Për sa i përket realizimit të programit mësimor GVJ vlerëson se Departamenti i Farmacisë angazhohet drejtpërdrejt dhe realizon vlerësimin e stafit akademik nëpërmjet kriterëve dhe standarteve të përshkruara në formularin përkatës. Ky formular dhe vlerësimi i përgjegjësit të Departamentit vendoset në dosjen personale të çdo pedagogu dhe arkivohen në departament.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Për vitin akademik 2016-2017 në këtë program studimi janë angazhur gjithsej **58 pedagogë**, nga të cilët **30** janë Personel Akademik Efektiv (PAE),), nga ku **1** Prof, **2** Prof.Asc. **16** Dr. dhe **11** Msc, dhe **28** janë Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku **3** Prof, **12** Prof.As, **10** Dr, dhe **3** Msc.

Ndërkohë për vitin akademik 2015-2016 programi i studimit realizohej nga **84 pedagogë** gjithsej, nga të cilët **32** ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) nga ku **11** Dr dhe **21** Msc, dhe **52** ishin Personel Akademik me Kontratë(PAK) nga ku **5** Prof, **20** Prof.As, **19** Dr dhe **8** Msc. Vihet re se në vitin akademik 2016-2017 ka një rritje të stafit akademik PAE me tituj dhe grada për realizimin e ngarkesës mësimore.

Ndërsa për vitin akademik 2017-2018 semestri i I gjatë vizitës në institucion u konstatua se personeli akademik efektiv për realizimin e programit do të jetë 22 pedagogë. Personel Administrativ (PA) përbëhet nga 19 persona ku 1 me gradën Dr dhe 18 Msc. (**Tabela – 2,3**).

Shpërndarja e ngarkesës është e tillë që mbi 2/3 e saj realizohet dhe mbulohet nga stafi me kohë të plotë, por jo në të gjitha rastet në përputhje me profilin e fushës së vet, madje një pedagog mbulon ngarkesë mësimore në disa lëndë të ndryshme.

Për për vitin akademik 2015-2016 **plotësohet kriteri i mbulimit mbi 70% të ngarkesës** mësimore nga staf me kohë të plotë (PAE mbulon 5984 orë, **80%** të ngarkesës dhe PAK 1410 orë, **20%** të ngarkesës) **por nuk plotësohet kriteri i raportit PAE/PAK mbi 70%. (40%/60%) (Tabela – 2,3)**

Për vitin akademik 2016-2017 **plotësohet kriteri i i mbulimit e 70 % të ngarkesës** nga staf me kohë të plotë (PAE mbulon 5659 orë **70%** të ngarkesës dhe PAK 2468 orë **30 %** të ngarkesës), **por nuk plotësohet kriteri i raportit PAE/PAK mbi 70% . (52%/48%) (Tabela – 2,3)**

Për vitet akademike 2010-2016 nuk plotësohet kriteri i raportit PAE/PAK mbi 70%

Llogaritja e ngarkesës mësimore në raport me koeficientët përkatës nuk është zbatuar për të gjitha veprimtaritë, në ngarkesën mësimore të realizuar për vitin akademik 2016-2017 shihet se është zbatuar për laboratorët keoficienti 0.8 por jo për leksionet dhe seminarët koeficientët përkatës. Stafi akademik pranohet në bazë të disa kriterëve ndër të cilat janë mesatarja e shkollës së lartë, eksperiencia në punë si dhe punë kërkimore e tyre. Stafi i miratuar për vitin akademik 2016-2017 karakterizohet nga eksperiencë në mësimdhënie, për disa nga dosjet e shqyrtuara u vu re mesatare e lartë e studimeve të larta. Nuk u konstatua tabelë vlerësimi me pikëzimet përkatëse në procesin e rekrutimit. Stafi duhet të

rrisë numrin e burimeve shkencore, pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe të stimulohen për fitimin e gradave shkencore dhe titujve akademike.

Tabelë përmbledhëse për plotësimin e kriterëve ligjorë lidhur me personelin akademik me programin e studimit për vitin akademik 2016-2017

TERMI	DEKLARIMI NË RVB	KONSTATIMI GJATË VIZITËS	KRITERI LIGJOR Udhëzimi i MAS NR. 20/09.05.2008 Udhëzimi i MAS nr. 11/dt.28.2011	KOMENT
Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE)	30 nga 58 gjithsej, nga ku 19 me titull/gradë dhe 11 Msc PAE 52%	30 nga 58 gjithsej, nga ku 19 me titull/gradë dhe 11 Msc PAE 52%	70 % i stafit akademik pergjegjes per programin e studimit duhet te jene me kohe te plote.	Nuk plotësohet.
Numri i Personelit Akademik me Kontratë (PAK)	28 nga 58 gjithsej, nga ku 25 me titull/gradë dhe 3 Msc PAK 48%	28 nga 58 gjithsej, nga ku 25 me titull/gradë dhe 3 Msc PAK 48%	Nuk ka	Duhet të ulet numri i stafit akademik me kohë të pjesshme dhe ngarkesa mësimore e tyre, ndërkohë që ka staf akademik me kohë të plotë me 45 orë ngarkesë mësimore.
Personel Administrativ (PA)	19 personel	19 personel		Plotësohet
Raporti PAE/PAK që mbulon ngarkesën mësimore	PAE mbulon 5659 orë dhe PAK 2468 orë PAE mbulon 70%	PAE mbulon 5659 orë dhe PAK 2468 orë PAE mbulon 70%	2/3 e ngarkesës mbulohet nga PAE	Plotësohet
Raporti PAE/PAK si nr stafi	30/28 (52%/48 %)	30/28 (52%/48 %)	70%/30%	Nuk plotësohet
Raporti Personel akademik / student	58 pedagogë / 428 studentë	58 pedagogë / 428 studentë	1/20 studentë	Plotësohet
Personel administrativ/student	19 PA/428 studentë	19 PA/428 studentë	1 PA /22 studentë	Plotësohet
Student /m2	Nuk është e qartë, sipërfaqja jepet në total jo për programin e studimit	Nuk është e qartë, sipërfaqja jepet në total jo për programin e studimit	Min 8 m ² /student	Të dhënat e infrastrukturës u kërkuan vetëm për programin e studimit por nuk u sollën.

Titullarët e lëndëve me grada dhe tituj	Nuk janë shprehur		Titullari i lëndës duhe të jetë me graden Dr dhe firmos syllabusin	Bazuar te Syllabuset e dorëzuara nga insitucioni jo gjithmonë përputhet titullari i lëndës me lektorin apo specializimi i lektorit me lëndën që ai jep. Te gjithë titullaret jane me grade/titull akademik
---	-------------------	--	--	--

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Aneksat 1/2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)**

Sipas dokumentacionit të paraqitur për vitin akademik 2016-2017, stafi akademik që është angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga **58 pedagogë** gjithsej, nga të cilët **30** Personel Akademik Efektiv (PAE), nga ku **1** Prof.Dr, **2** Prof.Asc. dhe **17** Dr. dhe **10** Msc, dhe **28** Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku **3** Prof. Dr, **12** Prof.As, **10** Dr dhe **3** Msc. Ndërsa për vitin akademik 2017-2018 semestri i I do të jenë të angazhuar vetëm për semestrin e parë **22** Personel Akademik Efektiv(PAE). Personel Administrativ (PA) përbëhet nga **19** persona ku **1** me gradën Dr dhe **18** Msc. (Tabela 2)

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (plotëso Aneksi 3)**

Në RVB deklarohen të dhënat e vitit akademik 2015-2016 dhe përpara vizitës në institucion të GVJ, pranë ASCAL janë dorëzuar në rrugë zyrtare të dhënat që i takojnë vitit akademik 2016-2017. Këshilli shkencor i programit të studimit për vitin akademik 2015-2016 sipas RVB përbëhet nga **8** anëtarë kurse për vitin akademik 2016-2017 gjate vizitës u konstatua se përbëhet nga **7** anëtarë dhe janë ruajtuar nga viti paraardhës vetëm **3** prej tyre. (Tabela 6)

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre**

Në RVB deklarohen të dhënat e vitit akademik 2015-2016 dhe përpara vizitës në institucion të GVJ, janë dorëzuar në rrugë zyrtare të dhënat që i takojnë vitit akademik 2016-2017. (Tabelat 7 dhe 8)

- Të dhëna sipas moshës së personelit**

Në RVB deklarohen të dhënat e vitit akademik 2015-2016 dhe përpara vizitës në institucion të GVJ, janë dorëzuar në rrugë zyrtare të dhënat që i takojnë vitit akademik 2016-2017.

Të dhëna sipas moshës së personelit të Departamentit të Farmacisë për vitin akademik 2016-2017 PAE dhe PAK

Personeli sipas titujve /gradave	Departamenti i Farmacise viti 2016-2017				
	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	-	-	-	-	1
As. Prof	1	-	-	1	-
Doktorë	6	6	2	2	-
Pedagogë (pa tituj)	-	-	-	-	-

Asistentë me Ma	6	5	-	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-	-	-
Personeli Administrativ	15	4	-	-	-
Departamenti i Farmacise 2016-2017					
Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë			2	2	1
As. Prof		4	4	3	-
Doktorë	2	2	5	-	-
Pedagogë (pa tituj)	-	-	-	-	-
Asistentë me Ma	3	-	-	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-	-	-

Të dhëna sipas moshës së personelit te Departamentit te Farmacise per vitin akademik 2015-2016 PAE dhe PAK					
Departamenti i Farmacise 2015-2016					
Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	-	-	-	-	-
As. Prof	1	-	-	-	-
Doktorë	6	5	-	-	-
Pedagogë (pa tituj)	-	-	-	-	-
Asistentë me Ma	16	5	-	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-	-	-
Personeli Administrativ	15	4	-	-	-
Departamenti i Farmacise 2015-2016					
Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	-	-	-	2	3
As. Prof	-	10	8	3	-
Doktorë	5	9	3	2	-
Pedagogë (pa tituj)	-	-	-	-	-
Asistentë me Ma	5	1	2	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-	-	-

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Bazuar në RVB si dhe nga konstatimet e kryera gjatë vizitës në institucion personeli akademik (PAE, dhe PAK) si dhe personeli administrativ, janë të pajisur me kontrata pune që ruhen në zyrën e burimeve njerëzore. Kontratat e punës janë të bazuara në kodin e punës dhe legjislacionin në fuqi. Ato kanë të përshkruar detyrimet dhe të drejtat e secilës palë që nënshkruan. Kontratat e PAE dhe PAK janë të përbëra nga pjesa e përgjithshme dhe ankeset ku specifikohet lënda dhe ngarkesa përkatëse për vitin akademik që nënshkruhet. Stafit administrativ ka kontratë të vecantë.

Bazuar në statutin e institucionit në ditën e vizitës (statuti i vjetër) kontratat për vitet akademike 2015-2016 dhe 2016-2017 duhet të nënshkruheshin nga administratori . U konstatua se:

- **Për vitin akademik 2015-2016** kontratat për stafin akademik janë nënshkruar nga “UFO” shpk me Znj. Silvi Leci pa specifikuar cilësinë e saj. Për studentët janë nënshkruar me përfaqësues Znj. Amanda Vrioni në cilësinë e administratores.
- **Per vitin akademik 2016-2017** kontratat e punës për stafin akademik janë nënshkruar midis “Ufo” shpk me përfaqësues Znj. Vera Ostreni në cilësinë e rektores së Albanian University dhe stafit akademik.

Bazuar në ligjin e arsimit të lartë Rektori është përfaqësues ligjor i Insitucionit të Arsimit të lartë jo i shpk-se që financon universitetin. (Ligji 80/2015 neni 39), si rrejdhim duhet të qartësohet në kontratat e punës ky status. Kontratat kanë pasaktësi lidhur me nënshkruesit dhe statusin e tyre.

Në statutin e ri të universitetit i cili hyn në fuqi në vitin akademik 2017-2018 kontratat për stafin akademik i nënshkruan rektori, në përputhje dhe ligjin e arsimit të lartë në fuqi.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga vizita në institucion GVJ vëren se stafi ndihmës/ administrativ i Departamentit të Farmacisë ishte shumë i angazhuar në kryerjen e detyrave të tij, qoftë në mbështetje të mësimdhënies, qoftë në detyrat për mbështetjen e institucionit në përgjithësi.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u kërkuan dhe u sollën në rrugë zyrtare Tabelat 4, 5, 7, 8 të përditësuara në kohë.

- Kontrate tip dhe të plotësuar PAE, PAK
- Kontratë tip për studentin

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik në disa raste nuk është i angazhuar në ngarkesë mësimore sipas fushës së tij të kualifikimit p.sh: vihet re që ngarkesa e të njëjtës lëndë shpërndahet në disa pedagogë me profile të ndryshme midis tyre. Gjithashtu ka raste kur i njëjti pedagog ka ngarkesë mësimore në lëndë të ndryshme si p.sh:</p> <p>-Dr.Nertil Xhaferraj realizon ngarkesë mësimore në Kimi të Përgjithshme dhe Inorganike, Kimi analitike, Kimi Fizike dhe Koloidale,</p> <p>-Dr. Ariela Struga realizon ngarkesë mësimore në Kimi Toksikologjike (në mospërputhje me profilin e saj) dhe në Kimi dhe Teknologji Ushqimore.</p> <p>Dukuri që con në një mësimdhënie jo cilësore dhe mosprofilizim të stafit akademik.</p> <p>Gjithashtu kjo dukuri shfaqet edhe tek lëndët profesionale ku në ngarkesën mësimore për vitin akademik 2016-2017 vihet re ky fenomen në Kimi Farmaceutike, Teknologji Farmaceutike.</p> <p>Po ashtu GVJ vëren se ka lëndë që mbuloohen nga pedagogë me profilizim të ndryshëm nga lënda që japin si p.sh.:</p> <p>Dr. Dafina Nazaj me doktoraturë në fushën e ekonomisë-menaxhimit, jep lëndën e Botanikës.</p> <p><i>Në ngarkesën mësimore mungojnë lëndë të planit mësimor siç janë ngarkesa mësimore e praktikës profesionale dhe ajo e udhëheqjes së temës së diplomës.</i></p> <p>Vërehet se një pjese e stafit akademik me kohë të plotë të</p>

Departamentit të Farmacisë shumicën e ngarkesës e kryen në departamente të tjera, ndërkohë që në pëthje me standartet shtetërore të cilesisë ky staf duhet ta kryejë shumicën e ngarkesës në departament si me poshte :

Pedagogu	Ngarkesa ne Dep. Farmacise 2016-2017	Ngarkesa ne Dep te tjera 2016-2017
Erind Allaj	60 orë	180 orë
Alba Laho	60 orë	165 orë
Anila Aliko	45 orë	225 orë
Elona Limaj	90 orë	180 orë

Ngarkesat mësimore të paraqitura për vitin akademik 2016-2017 përputhen pjesërisht me planin mësimor. Ka lëndë, të cilat në plan kanë numër të ndryshëm seminaresh nga ato të vendosura në ngarkesë si p.sh.: (seminaret e lëndës Kimi Organike semestri I). Gjithashtu vihet re se ngarkesa mësimore llogaritet për leksionet dhe seminaret pa koeficient, pra jo në përputhje me Udhëzimin e MASH Nr. 20 sipas të cilit insitucioni deklaroi se llogarisnin ngarkesat, ndërkohë që zbatohet koeficienti për orët laboratorike.

Nuk vihet re një normë e caktuar ngarkese për stafin akademik me kohë të plotë pasi ka staf, të cilët mbulojnë rreth **300-320 orë mësimore** dhe ka staf që mbulon rreth **100-150 orë** duke mos zbatuar raportin gradë/titull kundrejt ngarkesës mësimore. (Tabela 1,2, 3)

Institucioni konfirmoi gjatë vizitës se nuk ka normativë të brendshme të aprovuar për diferencime në ngarkesa mësimore. Ngarkesa mësimore vjetore është e specifikuar në aneks kontratën individuale.

Personeli ndihmës –akademik rezultonte të ishte i shpërndarë në përputhje sipas laboratorëve përkatës dhe gjithashtu gjatë vizitës në vend u konstatua se ishin të përgjegjshëm për detyrat e caktuara si dhe mirëmenaxhonin materialet didaktike dhe infrastrukturën përkatëse.

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Personeli akademik në përputhje me statutin dhe rregulloren është hallka e parë e propozimit të hartimit, ndryshimeve apo edhe riorganizimit të programit të studimit. Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” në kuadër të rekomandimeve të lëna nga akreditimi i parë anëtarët e departamentit kanë propozuar ndryshimet përkatëse në Këshillin e Fakultetit dhe Zyrën e kurrikulave për mendim.

Nga Procedura përkatëse e paraqitur nga IAL rezulton se propozimi dhe shqyrtimi janë bërë në përputhje me

	<p>statutin dhe rregulloret e njësive kryesore.(Statuti neni 10 pika b)</p> <p><i>Ndërkohë miratimi i ndryshimeve në lidhje me planet mësimore dhe programin nuk është bërë në përputhje me aktet normative të institucionit, duke u miratuar nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe jo nga Senati, kompetencë që përshkruhet në statut dhe rregulloren e Fakulteti te Shkencave Mjekesore (Rregullore e FSHM neni 9 pika d)</i></p> <p><u>Vihet re gjithashtu që insitucioni ka inicuar procedurën e plotësimit të rekomandimeve lidhur me përmiresimin e kurrikulës pas 5 vitesh nga momenti i lënies së tyre si rekomandime në akreditimin e parë, pikërisht në momentin e kërkesës për riakreditim.</u> Kjo vonesë nuk u justifikua nga institucioni.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik rezulton të jetë në përputhje me gradën/titullin e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, por procedura e ndjekur nuk është në përputhje me aktet normative të institucionit. Konkretisht në praktikën e rekrutimit e vënë në dispozicion gjatë vizitës u konstatua se procedura nuk ishte në përputhje me satutin e universitetit ku sipas të cilit kriteret i cakton Senati akademik dhe miratimin e bën po ky organ kolegjal. (Statuti neni 8 pika, i)</p> <p>Përcaktimi i ngarkesës mësimore sipas deklarimeve të IAL bëhet sipas Udhëzimit Nr. 20 /2008. Lidhur me këtë pikë nga dokumentacioni i dorëzuar, por edhe nga intervistat e stafit akademik rezulton se shpërndarja nuk bëhet në përputhje me udhëzimin e sipërcituar, pra sipas gradave, titujve dhe pozicionit. (referuar Ngarkesë mësimore 2016-2017) Ngarkesa mësimore përcaktohet si ankes në kontratën individuale të punës.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Rekrutimi i personelit bazuar në shembujt e dhënë për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 realizohet si vijon: fillimisht shpallen vendet vakante nga departamenti dhe pas dorëzimit të dosjeve të aplikantëve Komisioni i Vlerësimit i ngritur nga Këshilli i Fakultetit shpall fituesit (për 2016-2017).</p> <p>Rezultoni se procedura nuk është ndjekur në përputhje me procedurën e përshkruar në Rregulloren e Njësive Kryesore përgjegjëse për programin e studimit neni 22, ku thuhet specifikisht se <i>nevojat e njësive bazë, Dekani i përcjell në Senatin Akademik, i cili përcakton kriteret, procedurat dhe Komisionin e Vlerësimit.</i></p> <p>Në dokumentacionin e deklaruar nga IAL, Njësia Bazë propozon për çdo lëndë vendet vakante duke specifikuar</p>

vetë kriteret. Shqyrtimi i kandidatëve dhe miratimi i tyre bëhet në një listë të përbashkët, ku për vitin 2016-2017 nuk është e specifikuar lënda.

Nuk rezulton të ketë në materialet e paraqitura nga institucioni një sistem pikëzimi apo tabelë vlerësimi të kandidatëve, gjë që çon në konfuzion dhe jotransparencë të procesit të rekrutimit. Procesit të rekrutimit nuk i është bashkangjitur emërimi përkatës i Rektorit.

Personeli Akademik me Kohë të plotë për vitin 2016-2017 përbën 30/58 të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, pra 52 %.

Institucioni kryen proces vlerësimi të performancës, kryesisht nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, vlerësimi nga departamenti, të cilat së bashku shërbejnë për të plotësuar formularin e performancës individuale. Formulari vendoset në dosjen personale dhe nuk firmosej nga personi përkatës. Performanca diskutohet në përgjithësi në mbledhjet e departamentit. Nuk qartësohet nëse vlerësimi i performancës së stafit akademik i përcillet në mbledhje apo i komunikohet individualisht. Në takimin me stafin pati përgjigje të ndryshme.

Institucioni zotëronte një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, si dhe të njoftimeve për vende vakante.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e

Përgjegjësi i programit të studimit ka gradën “Doktor”. Titullarët e lëndëve janë kryesisht të fushës dhe janë minimalisht me gradën “Doktor” me përjashtim të lëndës Legjisllacion farmaceutik ose Fitoterapi.

Sipas RVB në programin e studimit 2015-2016 vihen re 12 lëndë për të cilat syllabusi është firmosur nga Lektori dhe jo nga Titullari i Lëndës si. P.sh.

Lënda	Titullari	Lektori	Firma
Fitoterapi	Dr.S.Vito	Dr,proc. R. Prifti	R.Prifti
Tekno.Farm.II	Prof.Dr.S. Durresi	Dr. S. Vito	S.Vito
Kimi Farm. II	Dr. A.Laho	Dr,proc. E.Kaloshi	E.Kaloshi
Legj. Far. dhe Farmakoeconom	Dr. A.Dama	Dr,proc. G.Goxhaj A.Rustemi	G.Goxhaj A.Rustemi
Kimi Farm. III	Dr. A.Laho	Dr,proc. E.Hilaj	E.Hilaj
<i>Gjuhë e huaj</i>	Prof.dr Afroim Karagiozi	Dr.Bledar Kurti	Dr.Bledar Kurti
<i>Fizikë</i>	Prof.Asc	Dr.	Dr.

praktikave profesionale.		dhurata Kuqi	Adhurim Hoxha	Adhurim Hoxha
	<i>Kimi Analitike</i>	Prof.asc Sonila Duka	Dr.Krenaida Taraj	Dr.Krenaida Taraj
	<i>Farmkognози</i>	Dr Sonila Vito	Dr.proc Dorina Shengjergji	Dr.proc Dorina Shengjergji
	<i>Teknologji Farmaceutike I</i>	Prof.Dr.S. Durresi	Dr. Kleva Shpati	Dr. Kleva Shpati
	<i>Teknologji Farmaceutike III</i>	Prof.Dr.S. Durresi	dfr	
	<i>Kimi Farmaceutike II</i>	Dr. A.Laho	Dr.proc Edlira Kaloshi	Dr.proc Edlira Kaloshi
<p>Përsa i përket gradës së titullarëve ajo plotësohet tek të gjitha, por i njëjti pedagog është titullar në më shumë se 2 lëndë. <i>Nga shpërndarja e ngarkesës për vitin akademik 2016-2017 vihet re se në shumë raste titullari i lëndës nuk ka fare ngarkesë në atë lëndë po në lëndë tjetër</i>. Disa te tjera figurojnë të pafirmosura si psh Anatomia humane.</p> <p>Per vitin akademik 2016-2017 syllabuset e dorezuara janë pa titullar dhe te pafirmosura . Nuk ka një program (syllabus) për praktikën profesionale.</p> <p>Autoritetet drejtuese siç janë Rektori, Dekani, Drejtuesi i Departamentit janë të punësuar me kohë të plotë pranë universitetit në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p> <p>Praktikat profesionale kryhen në përputhje me rregulloren e programit të studimit dhe me marrëveshje me subjekte farmaceutike private. Studenti kualifikohet për të kryer praktikën profesionale vetëm pasi ka fituar të gjitha kreditet. Studenti mban ditarin përkatës, i cili firmoset nga drejtuesi i praktikës dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Institucioni ka mjaftueshëm burime njerëzore dhe infrastrukturore për të udhëhequr dhe mbikëqyrur praktikat profesionale.</p>				
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>				
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të</p>	<p>Në RVB thuhet se deri para vitit akademik 2015-2016 studentët janë diplomuar kryesisht me provim diplome dhe një pjesë e vogël me temë diplome, dhe duke filluar nga viti aktual akademik 2017-2018 studentët do të diplomohen të gjithë me temë diplome në përputhje edhe me rekomandimet e lëna nga akreditimi i mëparshëm.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar gjatë vizitës në institucion, lista e studentëve me temat përkatëse të diplomës përbëhet vetëm nga 5 veta, gjë që nënkupton se</p>			

<p>natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>edhe në vitin akademik 2015-2016 dhe 2016-2017 nuk është aplikuar diplomimi i studentëve me temë diplome. Në listën e dorëzuar udhëheqësit e temave të diplomës për vitin akademik 2016-2017 rezultojnë me gradën “Doktor”.</p> <p>Drejtuesit e temave të diplomës nuk kanë në udhëheqje më shumë se 5 studentë kandidatë për diplomim.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Bazuar në listën e dorëzuar nga insitucioni të 5 temave të diplomës të kryera dhe udhëheqësve shkencorë përkatës, GVJ vëren se 2 prej tyre nuk përputhen me fushat e ekspertizës përkatëse të temës si p.sh: Dr. Krenaida Taraj është lektore e Kimisë analitike dhe fushën e temës që udhëheq e ka në fushën e Farmakognozisë, po ashtu edhe Dr. Ariela Struga e fushës së Kimisë ushqimore dhe Toksikologjisë, ka udhëhequr një temë diplome në fushën e Farmakognozisë.</p> <p><i>Pra ekspertiza e tyre nuk është e thelluar dhe në përputhje me temën që kanë marrë në udhëheqje.</i></p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka rekrutuar dhe trajnuar një numër të përshatshëm të konsiderueshëm personeli ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e tyre. Gjatë vizitës u realizuan takime me këtë kategori personeli, të cilët ishin të trajnuar, me eksperiencë dhe të përkushtuar për të pasur një mësimdhënie me cilësi të orëve laboratorike të programit të studimit ”Master i Shkencave” në “Farmaci”.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Stafi akademik e ka ngarkesën në përputhje me planin mësimor, por normat e tyre nuk janë në përputhje me një normativë ligjore apo vendim të brendshëm.</p> <p>Institucioni thekson se për shpërndarjen e ngarkesës mësimore zbatojnë Udhëzimin Nr.20 të MAS, por në dokumentin e dorëzuar nuk vërehet lidhje midis gradave/titujve dhe orëve mësimore siç rekomandohet në udhëzimin e sipërcituar. Shpërndarja është e çrregullt.</p> <p><i>Për llogaritjen e ngarkesës nuk përdoren koeficientët përkatës sipas tipit të aktivitetit mësimor (leksion,seminar) me perjashtim të laboratoreve.</i></p> <p>Ngarkesa mësimore i shtohet kontratës së punës si ankes kontrate.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

IAL –ja ka një bazë të dhënash të hollësishme të mirëorganizuar për personelin akademik, e cila gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë disponon për secilin semestër stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi në formën e vendimeve ekzekutive dhe informuese nga Dekani përkatës.

Institucioni përcakton kriteret, ku sipas statutit i përcakton Senati Akademik në bazë të propozimeve të njësisë bazë, kurse në procedurat e shqyrtuara ish-in propozuar tërësisht nga njësisë bazë. Kriteret dhe vendet vakante shpallen në ëeb.

Konkluzionet e vlerësimit:

- Bazuar në RVB, dhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në institucion GVJ vlerëson se Personeli Akademik

Per vitin akademik 2015-2016 plotësohet kriteri i mbulimit mbi 70% të ngarkesës mesimore nga staf me kohë të plotë (PAE mbulon 5984 orë dhe PAK 1410 orë) por nuk plotësohet kriteri i raportit PAE/PAK mbi 70%. (40.0/60.0)

Per vitin akademik 2016-2017 plotësohet kriteri i mbulimit të 70 % të ngarkesës (PAE mbulon 5659 orë dhe PAK 2468 orë) nga staf me kohë të plotë por nuk plotësohet kriteri i raportit PAE/PAK mbi 70% icili përbën 30/58 (52%).

Në vitin 2016-2017 janë bërë përmirësime dhe është arritur që 70% e ngarkesës të kryhet nga PAE, por si numër pëdagogësh PAE janë ende më pak se 70% e pedagogëve në total.

PA përbëhet nga 19 persona, të përkushtuar e me eksperiencë të mjaftueshme pune për të kryer funksionet e tyre.

- Për sa i përket shpërndarjes së ngarkesës është bërë një punë e mirë mbas 2015 për të arritur qëllimin që mbi 2/3 e saj të realizohet nga stafi me kohë të plotë, por jo gjithmonë në përputhje me profilin e fushës së vet, ndërkohë që llogaritja e ngarkesës mesimore në raport me koeficientët përkatës nuk është zbatuar. Nuk vihet re një normë e caktuar ngarkesë për stafin akademik me kohë të plotë pasi ka staf, të cilët mbulojnë rreth 300-320 orë mesimore dhe ka staf që mbulon rreth 45-150 orë duke mos zbatuar raportin gradë/titull kundrejt ngarkesës mesimore.
- Syllabuset e lëndëve në shumicën e tyre për vitin akademik 2015-2016 janë firmosur nga lektori dhe jo nga titullari i lëndës i cili mungon edhe në shpërndarjen e ngarkesës të lëndës përkatëse. U konstatua gjithashtu se gjatë vitit akademik 2016-2017 një pjesë e stafit akademik me kohë të plotë i departamentit të farmacisë pjesën më të madhe të ngarkesës e realizon në departamente të tjere.
- Miratimi i ndryshimeve në lidhje me planet mesimore dhe programin nuk është bërë në përputhje me aktet normative të institucionit, duke u miratuar nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe jo nga Senati, kompetencë që përshkruhet në statut dhe rregulloren e njësisë kryesore. (neni 9 pika d)
- Në lidhje me rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion janë vënë re parregullsi që çojnë në mungesë transparence si p.sh: fakti që Shqyrtimi i kandidatave dhe miratimi i tyre bëhet në një listë të përbashkët, pa u specifikuar lënda përkatëse si dhe pikezimi i tyre në përputhje me nenin 22 të statutit.
- Në udhëheqjen e diplomave GVJ mendon se Departamenti i Farmacisë dhe F.SH.M. kanë

mjaftueshëm staf akademik për t'i përshtatur fushën e ekspertizës së pedagogut me temën përkatëse të diplomës, gjë që duhet zbatuar gjate shpërndarjes se tyre pasi jo gjithmonë përshtatet fusha e udhëheqesit me temën e propozuar.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Gjatë vizitës në institucion u konstatua se ndërtesat në funksion të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” janë:

- Godina e ish gjykatës në rrugën e Durrësit
- Godina e ish Internacionalit në rrugën “Kajo Karafili”

të cilat ndodhen jo larg nga qendra e qytetit. Këto ndërtesa kanë qenë ekzistuese dhe të gjitha ambientet e tyre janë rikonstruktuar dhe janë përshtatur në klasa dhe laboratore në shërbim të programeve të studimit që kjo njësi ofron, me sipërfaqe totale rreth **4454 m²**.

Universiteti ka salla konferencash, të pajisura me kompjuter, video projektor, ekrane të mëdha, flipcharte, etj. Programi i Studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” ka në dispozicion një kompleks laboratorësh, në përputhje me plan-programin e lëndëve përbërëse, të cilët plotësojnë kërkesat e programeve përkatëse. Laboratorët janë të konsoliduar, të pajisur me mjete dhe reagentë në përshtatje me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit. *Duhet të merren masa për të vendosur aparat për të përfutur ujën e distiluar si dhe riparohen amortizimet perkatëse për sistemin e aspirimit.* Kompleksi i laboratorëve është me përbërjen e mëposhtme:

- Laboratori i Kimisë Analitike 1
- Laboratori i Kimisë Analitike 2
- Laboratori i Kimisë Organike
- Laboratori i Botanikes
- Laboratori i Teknologjisë Farmaceutike
- Laboratori i Kimisë së Përgjithshme Inorganike
- Laboratori i Kimisë Farmaceutike
- Laboratori i Farmakognozisë
- Preparatori i Teknologjisë Farmaceutike dhe Farmakognozisë
- Preparatori i Kimisë Farmaceutike, Kimisë Toksikologjike dhe Metodave Instrumentale të Analizës
- Dhoma e Aparaturave
- Laboratori i Kimisë Toksikologjike dhe Metodave Instrumentale të Analizës
- Laboratori i Anatomisë I
- Laboratori i Anatomisë II
- Laboratori i Fizikës

Theksojmë se është pozitive pajisja prej disa kohësh e laboratorit të kontrollit të barnave me aparat GAS-MAS, spektrofotometër UV-VIS si dhe HPLC të firmës prestigjioze Varian. Sygjerohet që këto aparatura duhet të përdoren më shumë nga studentët dhe i gjithë stafi akademik gjatë realizimit të procesit mësimor dhe gjatë punëve kërkimore.

Pjesë e rëndësishme e infrastrukturës është dhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, e cila punon nga ora 08.00 deri në orën 16.00. Për çdo student ka kartelë regjistrimi dhe sigurimi të

literaturës, si dhe sistem të kompjuterizuar të shërbimit bibliotekar. Janë aktive edhe regjistrimi në bibliotekat online si “Questia” dhe “Elsevier”, por vetëm me të drejtë leximi.

Pjesë e bibliotekës është dhe literatura bazë dhe e këshilluar e programit të studimit. Literatura është kryesisht e pajisur me botime të 10 viteve të fundit. Rezultoi që disa prej librave të literaturës bazë të jenë pa autorë ose të dhëna për autorsinë si p.sh. Kimi Farmaceutike (cikël leksionesh), Fizologji etj.

Institucioni ka në përbërje dhë Zyrën e informacionit dhe e recepsionit e cila mundëson dhe shërbimin të çdo informacioni që kërkohet si nga ana e studenteve ashtu dhe personave të tjerë të interesuar, lidhur me programin mesimor, oraret, numrat e klasave etj.

Institucioni ofron për aktivitetet e tjera si simpoziume, konferenca, seminare, leksione të hapura shkencore, një auditori i madh në korpusin në Bulevardi Zog i I^{re}, auditori i cili është i pajisur teknologjine perkatese.

Gjithashtu vlen të përmendet se infrastruktura ka në përbërje të saj edhe ambientet e shërbimit si kafene, vetëshërbim ushqimor me cmime të redukturara.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit:

- Salla për leksione – 2
- Klasa për seminare – 3
- Salla për aktivitete promovuese- 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale - 0
- Laboratorë për lëndët- 13
- Laboratorë informatike -0
- Salla interneti -1
- Salla për bibliotekë -1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj- 1
- Zyre informacioni për studentët -1
- Nyje hidrosanitare -3

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin -1
- Zyra për sekretarinë mësimore -2
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore -0
- Zyra për personelin akademik -2
- Zyre e Burimeve Njerezore -1

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u kërkuan dhe u sollën këto dokumenta:

- Planimetritë
- Lista e laboratorëve
- Lista e librave të bibliotekës
- Kopje të kopertinave të disa librave

Lidhur me infrastrukturen GVJ rezultoi se të dhënat e RVB përputhen me ato të konstatuara gjatë vizitës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ka vendodhje të qëndrueshme në më shumë se 6 vjet. Gjatë vizitës së GVJ u konfirmua se se shpejti do të ndërtohet një kampus i ri i cili do të sjellë rritje në cilësi të standardeve të infrastrukturës.</p> <p>Ndërtesat në shërbim të Fakultetit të Shkencave Mjekësore si dhe të programit të studimit janë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Godina e ish gjykatës në rrugën e Durrësit - Godina e ish Internacionalit në rrugën "Kajo Karafili të cilat ndodhen jo larg nga qendra e qytetit. Këto ndërtesa kanë qënë ekzistuese dhe të gjitha ambientet e tyre janë rikonstruktuar dhe janë adoptuar në klasa dhe laboratore në shërbim të programeve të studimit që kjo njësi ofron, me sipërfaqe totale rreth 4454 m². <p>Pavarësisht se programi i studimit realizohet në disa godina, institucioni përpiket të menaxhojë në mënyre efektive zbatimin e politikave dhe standardeve të cilësisë. Do ishte në funksion të rritjes së cilësisë organizimi i procesit mësimor në një kampus universitar të vetëm. Institucioni në kuadër të marrëveshjeve me subjekte farmaceutike ka krijuar infrastrukturën e duhur për realizimin e praktikave profesionale.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Pjesë rëndësishme e infrastrukturës është dhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore e cila ofron literaturë bazë dhe ndihmëse me një total prej 341 tekste. (referuar raportit vjetor 2016-2017)</p> <p>Për çdo student ka kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës, si dhe sistem të kompjuterizuar të shërbimit bibliotekar. Janë aktive regjistrimi në biblioteka online "Questia" dhe "Elsevier" por vetëm me të drejte leximi. Pjesë bibliotekës është dhe literatura bazë dhe e këshilluar e programit të studimit.</p> <p>Literatura është kryesisht e botimeve të 10 viteve të fundit.</p> <p><i>Rezultoi që disa prej librave të literaturës bazë të jenë pa autorë ose të dhëna për autorin si p.sh. Kimi Farmaceutike (cikël leksionesh), Fiziologji etj</i></p> <p>Nuk konstatoam ndonjë plan institucional për shtimin e zërave të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka funksiononte në oraret të përshtatshme dhe paralel me oraret e mësimin.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise	

të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Programi i Studimit Master i Shkencave në Farmaci ka në dispozicion

- Salla lekionesh, seminaresh
- Kompleks laboratorësh
- Zyra për stafin akademik dhe administrativ

Të cilat përmbushin kushtet dhe kriteret cilësore për realizimin e procesit mësimor.

Kompleksi i laboratorëve është ndërtuar në përputhje me plan-programin e lëndëve përbërëse të cilët plotësojnë kërkesat e programeve përkatëse.

Laboratorët janë të konsoliduar të pajisur me mjete dhe reagentë në mënyre të përshtatshme me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit.

Duhet të merren masa për të vendosur aparat për të përftuar ujë të distiluar.

Kompleksi i laboratorëve është me përbërjen e mëposhtme në përputhje me grup-lëndet e programit

- Laboratori i Kimisë Analitike 1
- Laboratori i Kimisë Analitike 2
- Laboratori i Teknologjisë Farmaceutike
- Laboratori i Kimisë së Përgjithshme Inorganike
- Laboratori i Kimisë Organike
- Laboratori i Botanikës
- Laboratori i Kimisë Farmaceutike
- Laboratori i Farmakognozisë
- Preparatori i Teknologjisë Farmaceutike dhe Farmakognozisë
- Preparatori i Kimisë Farmaceutike, Kimisë Toksikologjike dhe Metodave Instrumentale të Analizës
- Dhoma e Aparaturave
- Laboratori i Kimisë Toksikologjike dhe Metodave Instrumentale të Analizës
- Laboratori i Anatomisë I
- Laboratori i Anatomisë II
- Laboratori i Fizikës

Është pozitive pajisja prej disa kohësh e laboratorit të kontrollit të barnave me aparat GAS-MAS, spektrofotometër Uv-VIS si dhe HPLC të firmës prestigjioze Varian. Theksojmë që këto aparatura të jenë më të përdorshme nga studentët dhe stafi akademik në funksion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor

Konkluzionet e vlerësimit:

- Institucioni ka vendosur prej më shumë se 6 vjetësh dhe në funksion të programit të studimit janë dy godina. Këto ndërtesa kanë qënë ekzistuese dhe të gjitha ambientet e tyre janë rikonstruktuar dhe janë adoptuar në klasa dhe laboratorë në shërbim të programeve të studimit. Programi i Studimit Master i Shkencave në Farmaci ka në dispozicion, salla lekionesh, seminaresh, kompleks laboratorësh, zyra për stafin akademik dhe administrativ. *Do ishte në funksion të rritjes së cilësisë organizimi i procesit*

mësimor në një kampus universitar i ndërtuar me një strukturë që ka si qëllim krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për njesitë bazë dhe kryesore si dhe shtimi i zyrave për stafin akademik.

- Institucioni ka në dispozicion të programit të studimit bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Mjekësore e cila ofron literaturë bazë dhe ndihmëse përkatëse. Rezultoi që disa prej librave të literaturës bazë të jenë pa autorë ose të dhëna për autorsinë si psh Kimi Farmaceutike (cikël leksionesh), Fizologji etj. *Nuk konstatoam ndonjë plan institucional për të shtimin e zërave të bibliotekës. Janë aktive regjistrimi në biblioteka online “Questia” dhe “Elsevier” por vetëm me të drejte leximi*
- Kompleksi i laboratorëve është ndërtuar në përputhje me plan-programin e lëndëve përbërëse të cilët plotësojnë kërkesat e programeve përkatëse. Laboratorët janë të konsoliduar të pajisur me mjete dhe reagentë në menyrë të përshtatshme me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit, *por institucioni duhet të hartojë plan masa për shmangur dhe ruajtur në minimum amortizimin tyre.*
- Gjatë vizitës GJV nuk konstatoi ambjent të vecante rekreacioni për tudentët.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Burimet financiare të universitetit janë vetëm nga tarifat e shkollimit

Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm

Të ardhurat nga tarifat e shkollimit janë rritur në vitet 2015-2016 dhe 2016-2017 meqë ka pasur një numër të lartë transferimesh. Gjithashtu dhe shpenzimet respektive janë rritur referuar të dhenave nga të RVB. Rreth 45 % e këtyre burimeve të të ardhurave shpenzohen për paga, rreth 25% për shpenzime infrastrukture dhe 20-30 % për inventare. Referuar të dhënave programi i studimit ka stabilitet financiar dhe analiza financiare rezulton me fitim.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- T ardhurat në këtë program studimi janë 100 % nga tarifat për dhe gjatë shkollimit

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet për studentë dhe kostot për student, nuk ka të dhëna. Në analizen financiare janë treguar shpenzimet në total, të cilat zënë rreth 22 % të të ardhurave. Shihet se zëri i shpenzimeve për kërkimin shkencor është i papërfillshëm.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- *Analiza financiare*

Të dhënat e marra gjatë vizitës përputhen me atë të deklaruara në RVB. Nga të dhënat vihet re se vperimtaria financiare e institucionit mbështetet vetëm në të ardhura nga tarifat e shkollimit gjë që përbën risk financiar në rast të rënies së numrit të të regjistruarëve. Gjithashtu rezulton se një pjesë e rëndësishme e zërit të të ardhurave shkon për paga gjë që rrit koston për student.

Do të ishte në interes të rritjes së cilësisë së menaxhimit që të rriten të ardhurat nga burime të tjera financiare, të ulen kostot administrative si dhe të rritet zëri i buxhetit për kërkimin shkencor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Institucioni harton një raport financiar për çdo vit buxhetor të certifikuar nga ekspertë të jashtëm.</p> <p>Institucioni vuri në dispozicion përveç të dhënave të RVB –së edhe një analizë financiare në lidhje me zërat e të ardhurave, zërat e shpenzimeve dhe fitimin bruto.</p> <p>Burimet financiare të universitetit janë vetëm nga tarifat e shkollimit</p> <p>Vihet re se institucioni mbështetet vetëm në të ardhura nga tarifat e shkollimit gjë që përbën risk financiar në rast të rënies së numrit të të regjistruarëve. Gjithashtu rezultoi se një pjesë e rëndësishme e të të ardhurave shkojnë për paga gjë që rrit koston për student.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni referuar raportit financiar të deklaruar dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare si në aspektin e gjenerimit e të ardhurave por edhe në mirëmenaxhimin e kostove operative.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni harton një raport financiar për çdo vit buxhetor të certifikuar nga ekspertë të jashtëm me zëra specifike në përputhje aktet ligjore tatimore në fuqi.</p> <p>Burimi i vetëm i të ardhurave është nga tarifa e shkollimit gjë që përbën risk financiar në rast të uljes së numrit të studentëve .</p> <p>Institucioni referuar analizës financiare të paraqitur tregon stabilitet financiar, si dhe dëshmon se ka kapacitet për të gjeneruar të ardhura nga burime të tjera.</p> <p><i>Institucioni duhet të hartojë plan masa për të rritur të ardhurat nga burime të tjera përveç tarifës së shkollimit sic janë grantet, shërbimet dhe projektet.</i></p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur që nga viti 2009 me krijimin e Zyrës të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë të nxjerra nga ASCAL.

Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, parashikohet nga neni 67 i Statutit dhe në nenin 13 të Rregullores së brendshme të Universitetit. Në mbështetje të Statutit, dhe akteve nënligjore në fuqi, kjo Zyrë ushtron funksion mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues dhe administrative me strukturat e tjera akademike dhe administrative të Universitetit, si dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Ajo gjithashtu është e pajisur me një rregullore specifike ku shprehen qartë kompetencat dhe detyrat e kësaj hallke. Zyra realizon një raport vjetor në përputhje me rregulloren përkatëse por nuk është i publikuar ose i vënë në dispozicion. Në raportin vjetor të 2016-2017 hartuar nga departamenti i farmacisë përshkruhen hollësisht të gjitha kritret ligjore dhe standartet e realizimit me cilësi të programit të studimit sic janë realizimi i ngarkesës mësimore, analiza e pyetësoreve të studentëve, kalushmëritë etj. Kjo zyrë ka pasur përbërje të ndryshme në vitet e fundit akademike. Anëtari më i vjetër rezulton të jetë larguar. Ka mospërputhje më të dhënat e dhëna në RVB ku thuhet se përbëhet nga 5 anëtarë, ndërkohë gjatë vizitës u raportua se kjo njësi ka në përbërje 3 anëtarë konkretisht: Dr. Desara Agaj, Msc. Sidita Coniku dhe Msc. Krenaida Taraj.

ZSBC ka bërthamen e vet koordinuese prej 2 vetash në cdo njësi baze duke lehtësuar marrjen dhe përpunimin e informacionit. Gjithashtu një nga anëtarët e NJSBC është edhe përfaqësues i Zyrës së Kurrikulave gjë që mund të cojë në mbivendosje të kompetencave.

Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, raporteve semestrale të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të departamenteve, si dhe rezultateve të arritura nga studentët.

Rezultoi se formatet e pyetësorëve të studentëve nuk kanë pasur asnjë përmirësim në 5 vitet e fundit si dhe nuk aplikohen pyetësoret anonime për stafin akademik dhe administrativ gjë që do conte në një përfaqësim të zërit të tyre në raportet përkatëse dhe përmirësim të cilësisë së aspekteve dhe problematikave përkatëse.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC

Kjo Zyrë zhvillon dy pyetësorë anonimë në vit (para sezoneve të provimeve dimër dhe verë) drejtuar studentëve me pyetje kryesisht mbi cilësinë e "mësimdhënies dhe shërbimeve administrative. Të dhënat përpunohen nga sistemi dhe iu përcillen departamenteve përkatëse për procedura të mëtejshme. U kërkua një mostër përpunim rezultatesh dhe më tej një shembull ku senati akademik ka marrë masa në bazë të rezultateve të këtyre pyetësorëve. Në lidhje me Programin e studimit Master i Shkencave në Farmaci problemet që kishin dalë lidheshin me infrastrukturën, sistemin elektronik të sekretarisë mësimore dhe performancës së një pedagogu.

Për sa i përket hapave të mëtejshëm që ishin ndërmmarrë ishte sistemi elektronik i sekretarisë po ndërtohej në përputhje me kërkesat e studentëve si dhe performanca e pedagogut ishte shqyrtuar edhe nga Shefi i Departamentit të Farmacisë. Më tej procedura i kishte kaluar Dekanes së Fakultetit dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore. Pedagogu kishte dhënë dorëheqjen.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

ZBSC organizon edhe biseda të drejtpërdrejta me fokus Grupe të përbëra prej 8-12 studentësh të zgjedhur në mënyrë rastësore dhe nxjerr të dhëna në lidhje me sigurimin e cilësisë në institucion. Këto rezultate iu bashkangjiten rezultateve të 2 pyetësorëve në lidhje me vlerësimin e performancës së stafit akademik, i dërgohen Departamentit dhe përmbledhen në Raportin Vjetor të Dekanatit. Raporti më i fundit është ai i datës, 04.10. 2017. GVJ nuk konstatoi raport të vetëvlerësimit të Zyrës si dhe raport vjetor të ZSBC

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Në nivel Departamenti janë caktuar 2 pedagogë të brendshëm për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë, të cilët të dhënat e grumbulluara ia përcjellin ZSBC. Funksionojnë si strukturë mbështetëse për sigurimin e cilësisë në institucion.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në pyetësin e dorëzuar nga IAL janë pyetur 37 studentë, një numër i vogël në raport me numrin total të studentëve.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Rezultatet e vetëvlerësimeve periodike, së bashku me propozimet për masat e nevojshme që duhen ndërmarrë, i përcillen të gjitha hallkave të institucionit deri tek Senati Akademik, i cili merr masat e duhura.

Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitës në institucion

- Rregullore e zyrës
- Perpunim i rezultateve të pyetësorit
- Raport vjetor në nivel departamenti
- Shembull i ecidentimit të problematikave dhe zgjidhejs se plan masave
- Perberja e ZSBC (*shih Tabela 9*).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); b. Dëgjime në auditor; c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; 	<p>Bazuar në RVB si dhe gjendjes së konstatuar gjatë vizitës në Institucion, vlerësojmë se, Albanian University bën vlerësim të përvitshëm të ecurisë së programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci”.</p> <p>Metodat që përdoren janë pyetësorët anonimë drejtuar studentëve, të dhëna nga fokus grupet, formularët e vlerësimit të performancës që plotësohen nga Shefi i Departamentit për çdo anëtar të PAE dhe PAK;</p> <p>Informacionin e grumbulluar me metodat e përmendura më sipër, pas perpunitimit statistikor institucioni e përfshin në Raportin Vjetor të vetëvlerësimit për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë; Rezultatet e vlerësimit bëhen publike për stafin në mbledhjet e Departamentit. Masat e nevojshme merren nga Senati Akademik me propozim të Departamentit dhe ZSBC.</p> <p>Theksojmë se struktura e pyetësoreve nuk ka ndryshuar në 5 vitet e fundit dhe nuk ka ende pyetësorë për stafin akademik të cilët do shërbenin edhe për të dhënë mendimet dhe problemtikat që ata hasin gjatë menazhimit institucional.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit, Albanian University përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta. Bazuar në RVB dhe në dokumentat e kërkuara gjatë vizitës në institucion këto metoda konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pyetësorë për studentët të zhvilluara dy herë në vit,

<p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - biseda midis anëtarëve të ZBSC dhe fokus grupeve të studentëve, - formularëve mbi performancën e stafit akademik të plotësuar nga Shefi i Departamentit - rezultatet e arritura nga studentët në provime dhe kologjume.
---	---

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion u konstatua se Albanian University harton Raportin Vjetor në trajtën e një broshure ku përfshihen edhe të dhënat, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion u konstatua se as rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e brendshëm, as Raporti Vjetor i Albanian University nuk publikohet në ndonjë faqe interneti, video e audio etj.;</p>
---	---

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Analiza vjetore për vlerësimin e ecurisë së programit të studimeve "Master i Shkencave" në "Farmaci" kryhet në nivel Departamenti për të cilin hartohet një raport vjetor, i cili përfshihet në raportin vjetor të institucionit.</p> <p>Raporti vjetor që insitucioni ka dorëzuar i përket vitit akademik 2015-2016, gjatë vizitës në Institucion GVJ kërkoi edhe raportin vjetor të programit të studimit për vitin akademik 2016-2017. Në raport thuhet se studentët që nuk kanë frekuentuar nuk janë lejuar të futen në provime. Gjatë vizitës dhe takimit me studentët ,në lëndën Kimi Farmaceutuike 3, për vitin akademik 2016-2017 pavarësisht mosfrekuentimit total rezultonte në procesverbalin e provimit me vlerësimin përkatës.</p> <p>Politikat e Albanian University me synim përmirësimin e programit të studimeve "Master i Shkencave" ne "Farmaci" konsistojnë në krijimin e kushteve stafit dhe studentëve për pjesëmarrje në konferenca shkencore, botime në revistën e Universitetit OPTIME me ISSN.</p> <p><i>Duhet te rritet mobiliteti i stafit akadmike dhe studenteve gjithashtu.</i></p>
--	---

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Në momentin e vizitës Universiteti Privat "Albanian University", është në proces akreditimi në nivel institucional me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë (QAA), në proces riakreditimi për programin e studimeve "Master i Shkencave" në "Farmaci"

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Albanian University funksionon ZSBC me 3 anëtarë. Kjo zyrë përdor mënyra të ndryshme për sigurimin e cilësisë dhe mbështetet në nivel departamenti edhe nga 2 përfaqësues të këtij të fundit. Zyra është e përbërë nga dy komisionerë referuar rregullores përkatëse

1. Komisioni i vlerësimit institucional
2. Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë.

U konstatua se nuk është konsistente përbërja zyrës, pasi ndryshe është deklaruar në RVB me 5 persona dhe ndryshe u konstatua gjatë vizitës ku u konfirmua përbërja prej 3 vetash. Gjithashtu në rregulloren e kësaj njësie nuk specifikohet përbërja e saj por vetëm përbërja e komisionit të vlerësimit institucional. Gjithashtu pavarësisht se njësia ka në përbërje dy njësi, nuk ka deklaruar raport vetvleresimi për punën vjetore të saj.

Anëtari më i vjetër ka qënë për një periudhe kohore prej 7 vitesh dhe në momentin e vizitës figuron të jetë larguar nga detyra.

Njëra preja anëtarëve është pjesë edhe e zyrës së Zyrës së zhvillimit të Kurrikulave gjë që con në mbivendosje kompetencash.

ZSBC funksionon në bazë të procedurave të përcaktuara në statutin e institucionit dhe që nga Dhjetori 2016 ka edhe një rregullore të veçantë. Në ëbistin e këtij institucioni nuk ka të publikuar raport vjetor të NJSBC, as në dokumentacionin e vënë në dispozicion.

Bazuar në RVB, dhe në vizitën në institucion mund të thuhet se mbikëqyrja e Programit të studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" kryhet here pas here nëpërmjet ZSBC. Theksojmë se është praktikë pozitive që zyra ka koordinatorët përkatës në cdo departament gjë që lehtësohen komunuikimin dhe marrjen e të dhënave.

Informimi i studentëve dhe i personelit të Albanian University, mbi Programin e studimit dhe rëndësinë e sigurimit të cilësisë në të kryhet nëpërmjet takimeve direkte.

Strategjia, politika e institucionit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë konsiston në zhvillimin e përvitshëm të pyetësorëve dhe plotësimin e

formularëve të performancës nga personeli.
Procedurat janë miratuar në përputhje me Statutin e AU (nenet 25, 66).

Konkluzionet e vlerësimit:

- Bazuar në RVB dhe takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se ka përpjekje serioze për vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative duke kombinuar mënyra të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Zyra prej dhjetorit 2016 ka rregulloren saj specifike.
- *U konstatua se nuk është konsistente përbërja e kësaj zyre.* Përbërja e ZSBC në RVB deklarohet me 4 anëtarë për vitin akademik 2015-2016 dhe me 5 anëtarë për vitin akademik 2016-2017 anëtarë, ndërkohe gjatë vizitës rezultoi me 3 anëtarë. Në rregulloren e kësaj njësie gjithashtu nuk specifikohet përbërja saj. *GVJ sygjeron plotësimin e saj me anëtarë dhe ndarjen nga Zyra e kurrikulave (i njëjti person bën pjesë si në ZSBC edhe në atë të kurrikulave).*
- Gjithashtu pavarësisht se njësia ka në përberje dy njësi, dhe në rregulloren e saj ka të detyrueshme hartimin e një raporti vjetor neni 3 pika 6, në ëbsite-in e ketij institucioni nuk ka të publikuar raportin vjetor të NJSBC, as në dokumentacionin e vënë në dispozicion.
- Gjithashtu në funksion të përmirësimit të cilësisë GVJ sygjeron përditësimin e herëpashershëm të pyetësorëve; zhvillimin e sondazheve anonime edhe tek personeli akademik e dhe administrativ për të dëgjuar edhe zërin e tyre.
- Theksojmë se është praktikë pozitive që zyra ka koordinatorët përkatës në cdo department gjë që lehtëson komunikimin dhe marrjen e të dhënave.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Farmacisë. Misioni dhe objektivi i programit të studimit në përgjithësi përputhet me përmbajtjen e programit, por nuk ka ndonjë lëndë specifike që të shërbejë për formimin e liderave të aftë për të drejtuar sistemin farmaceutik shqiptar. Viti akademik është organizuar në 2 semestra me nga 15 javë, pra 30 javë mësimore në auditor. Studimet zgjatin 5 vjet me një total kreditesh 300 ECTS. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomë “Master i Shkencave” “Farmaci”⁷ miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve me *Urdhër Nr. 18 Datë 19.01.2017 Nr. Prot. 457.*

Kurrikula mësimore është ndryshuar në zbatim të sugjerimeve të bëra nga GVJ e vitit 2010, por puna ka nisur vetëm në tetor të vitit 2015 dhe nuk është arritur që të gjithë elementët si lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, të përmirësohen konform kriterëve të përcaktuara.

Literatura e detyruar është në gjuhën shqipe dhe gjendet edhe në bibliotekën e universitetit. Fondi i teksteve në bibliotekë posaçërisht për studentët e farmacisë përbëhet nga 96 tekste origjinale ose të përkthyer.

- Programi i studimit është i ndërtuar vetëm me lëndë, nuk ka module përbërëse duke cuar në lëndë me sasi të lartë kreditesh si p.sh.: Kimi Organike me **14 kredite**, Kimi Analitike me **14 kredite**, Kimi Farmaceutike I me **12 kredite** etj., gjë që çon në penalizim të ecurisë së studimeve të studentëve në vitet e mësipërme apo edhe në mobilitetin e tyre. Në qoftë se këto lëndë do të organizohen në module studentët kanë mundësi të fitojnë një pjesë të krediteve, duke mos i penguar për kalueshmërinë në vite, por edhe për mobilitetin e tyre jashtë universitetit.
 - Koeficientët e përdorur për të konvertuar kreditet e secilës veprimtari mësimore në orë mësimore dhe raportet midis vetë veprimtarive formuese nuk janë respektuar sipas udhëzimeve përkatëse të MAS p.sh.: seminarët herë llogariten me 10 orë herë me 15 orë për 1 kredit (kriteri është 6-8 orë), laboratorët luhaten nga 15 orë për 1 kredit (18-25 orë).
 - Lëndët me zgjedhje janë në përqindje të ulët rreth 4 kredite, nga 20-24 kredite që është kriteri ligjor.
 - Tema e diplomës është në disa dokumentacione 10 kredite dhe në disa të tjera 15 kredite, por jashtë limiteve referuar udhëzimit përkatës (rreth 20-30 kredite)
 - Shpërndarja e lëndëve sipas tipologjisë A, B, C, D, E, F shpesh është e pasaktë dhe në dokumentacione të ndryshme nuk është konsistente. Kështu p.sh.: lënda Biokimi, e cila është lëndë me karakter të përgjithshëm, klasifikohet si lëndë karakterizuese e programit. Lënda Fiziologji, e cila është lëndë integruese e programit është klasifikuar si lëndë me karakter të përgjithshëm. Ky klasifikim i dërguar nga institucioni për vitin akademik 2016-2017 nuk përputhet me atë të paraqitur në rregulloren e programit (miratuar tetor 2016), tek e cila janë rregulluar një pjesë e lëndëve.
- Aktivitetet e tipit C, D, E, F gjithashtu nuk janë në përputhje me përqindjet normative ligjore. Psh përqindja e lëndëve me zgjedhje etj.
- Nuk pasqyrohet ngarkesa mësimore vjetore dhe ajo javore për studentin në planin mësimor. Nga llogaritjet ajo luhetet brenda normave 20-25 orë në javë.
 - Në planin mësimor nuk ka të evidentuar aktivitete mësimore në formën e projekteve.
 - Në vitin e tretë, të katërt dhe të pestë në planin mësimor të rishikuar 2016-2017 leksionet të llogaritura në % përbëjnë më pak se 50% të totalit (kriteri ligjor 50-85%, Udhëzimi 15, Dt. 4.4.2008).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Bazuar në RVB dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion GVJ vërehet se Programi i studimit Master i Shkencave në "Farmaci" në Albanian University ka si qëllim dhe objektiv të tij përmbushjen e nevojave të tregut shqiptar të punës me figura profesionale të afta për të drejtuar e menaxhuar sistemin farmaceutik shqiptar. Ky program ka filluar në vitin akademik 2005-2006 me kohëzgjatje 4 –vjeçare (8 semestra, 240 ECTS), dhe me Urdhër të MAS Nr. 226, datet. 21/07/2009 ka kaluar në sistem 5 vjeçar (10 semestra, 300 ECTS).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ vëren se ky plan ka pësuar ndryshime në masën jo më shumë se 20% të tij

Ky plan mësimor është ndryshuar në zbatim të rekomandimeve të bëra nga GVJ gjatë akreditimit të programit në vitin 2010. Grupi i punës është ngritur me parë por procesi ka filluar para një viti, vetëm në fund të viti 2015 dhe si pasojë ka ende aspekte që duhen përmirësuar. (Shih Aneksi 6) Plani i studimit aktual për brezin 2017-2022 (shiko Aneksin 8)

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 6-11 orë në auditor dhe 19-14 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 8-12 orë në auditor dhe 17-13 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 10-15 orë në auditor dhe 15-10 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 13.5 orë në auditor dhe 11.5 orë punë e pavarur e studentit
- Provimit përfundimtar 225 orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit

Ne planin mësimor nuk janë zbatuar koeficientët në përthje me udhëzimin përkatës.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara Në planin mësimor aktual GVJ vëren se janë bërë ndryshime në vijim të rekomandimeve të përfshira në RVJ të vitit 2010 për akreditimin e programit të studimit Master Shkencor Farmaci (shih Aneksi 8)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Në planet mësimore 2015-2016 në lidhje me personelin akademik GVJ vëren se është plotësuar **kriteri në lidhje me realizimin e 70%** të ngarkesës së programit të studimit nga PAE konkretisht (PAE realizon 5984 orë mësimore, pra **80%**), dhe PAK (PAK realizon 1410 orë mësimore, pra **20%**). Ndërsa numri i PAE kundrejt numrit të përgjithshëm të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, konkretisht **32** personel akademik efektiv(PAE) nga **84** personel gjithsej,përbën më pak se **38%** të tij, **pra nuk plotësohet kriteri në lidhje me numrin e stafit akademik efektiv.** (Tabela 1dhe 3)

Në planet mësimore 2016-2017 në lidhje me personelin akademik GVJ vëren se është plotësuar **kriteri në lidhje me realizimin e 70%** të ngarkesës së programit të studimit nga PAE konkretisht(PAE realizon 5659 orë mësimore, pra **70%**) dhe PAK (PAK realizon2468 orë mësimore, pra **30%**).). Ndërsa numri i PAE kundrejt numrit të përgjithshëm të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, konkretisht **30** personel akademik efektiv(PAE) nga **58** personel gjithsej,përbën **52%** të tij, **pra nuk plotësohet kriteri në lidhje me numrin e stafit akademik efektiv.** (Tabela 2dhe 3)

GVJ vëren se ka pedagogë që japin deri në 4 lëndë të ndryshme dhe që kanë ngarkesë sa dyfishi i normës së një PAE bazuar në përputhje me gradë shkencore/titull akademik siaps Udhëzimit nr. 20 MAS, duke cuar në mosprofilizimin e tyre në një lëndë të caktuar.

Nga takimi me stafin akademik pasja e një ngarkese shumë të ulët justifikohet me faktin se merren me punë kërkimore/ udhëheqje temash diplome etj por realisht nuk vërehet një ndarje e tillë e stafit nga ana e insitucionit.(shih Aneksi 7).

Planet mësimore janë të sigluara nga dekani por jo të miratuara nga Rektori si kryetar Senati akademik. .

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Programi i studimit ka pjesë përbërse dhe syllabuset e lëndëve të cialt janë të pajisura me rubrikat e detyrueshme sipas udhëzimit përkatës të MAS dhe standarteve shtetërore. Vihet re që syllabuset shpesh herë nuk kanë të specifikuar vitin akademik si dhe firmosen nga lektori jo nga titullari.

Në syllabus ka të dhëna për ngarkesën e lëndës, literaturën, temat, dhe gjithashtu dhe sistemin e vlerësimit. Studentët vlerësohen si gjatë vitit mësimor edhe në përfundim të tij. Gjatë vitit mësimor studenti mund të grumbullojë deri në 40 pikë për frekuentim dhe pjesëmarrje aktive në mësim, nga kontrollat e pjesëshme, nga detyrat e kursit dhe në fund deri 60 pikë në provimin përfundimtar me shkrim. Studenti në përputhje me rregulloren duhet të frekuentojë 75% të seminareve dhe 100% laboratorët për të fituar të drejtën të futet në provim në sezonin e qershorit. Nëse ka 25% mungesa nuk futet në sesionin e qershorit, por futet në sesionin e shtatorit. Nëse ka mbi 50% mungesa nuk kualifikohet dhe rifekuenton lëndën në vitin pasardhës. Gjate vizitës në institucion u konstatua nga një studente se për lëndën *Kimi Farmaceutike* e cila edhe pse nuk e kishte frekuentuar lëndën ishte klasifikuar për sesionin e qershorit. Gjate takimit me studentët sistemi i vlerësimit ishte qarte. Literatura e detyruar blihet nga studentët, gjithashtu gjendet edhe në Bibliotekën e AU për shfletim në ambjentet e kësaj bibliotekë

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset në përmbajtje janë të përditësuara dhe në përputhje me objektivin e lëndës përkatëse. Kanë probleme të tilla ku shpesh janë të firmosura vetëm nga lektori dhe jo nga titullari i lëndës si dhe vitin akademik për të cilin miratohen.

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

Syllabuset per vitin akademik 2015-2016, 2016-2017.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është akredituar në vitin 2010 me disa rekomandime. Një pjesë e rekomandimeve janë plotësuar gjatë periudhës 2010-2017 dhe tashmë programi është i organizuar në module, të cilat vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë mund të grumbullojë gjatë një viti një sasi prej 60 kreditesh;
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë	Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se programi i studimit “Master i Shkencave” në Farmaci pranon studentë që zotërojnë një Diplomë Pjekurie dhe i pajis studentët me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim profesional. Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci”

<p>profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>synon t’i pajisë studentët me njohuri të zgjeruara shkencore, që përbëjnë bazën për shkencat farmaceutike dhe njohuri specifike profesionale që lidhen me shërbimin farmaceutik.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në Farmaci i pajis studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike në fusha të ndryshme si anatomi, fiziologji, kimi, farmakologji, teknologji, legjislacion etj., si dhe trajnim profesional apo për kërkim shkencor në fushën farmaceutike. Pas përfundimit të studimeve si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për farmacinë, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesionit të farmacistit.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” në Albanian University, i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në Farmaci krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet të mëtejshme, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor;</p>
---	---

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbytja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Duke u mbështetur në sa thuhet në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në Albanian University, GVJ vlerëson se përmbytja dhe renditja e objektivave të programit të studimit “Master i Shkencave” në Farmaci synon përgatitjen e farmacistëve të ardhshëm të aftë për të punuar në sektorin privat apo shtetëror farmaceutik në Shqipëri, dhe është në përputhje me nivelin e studimeve. GVJ mbasi shqyrtoi RVB dhe dokumentat e marra gjatë vizitës në institucion vëren se metoda e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive në kombinim me provimet përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p> <p><i>Ne programin e studimit duhet të shtohen edhe projektet si element përbërës i planit mësimor për të shtuar aftësitë e sintezës dhe krijuesë të studentit për fushën në studim.</i></p>
--	---

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;

Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;

Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.

Bazuar në RBV, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” dhe aktivitetet ekstrakurrikulare mbështeten nga 2 marrëveshje bashkëpunimi me universitete europiane për programin e studimit. Në këtë drejtim institucioni duhet të rrisë marrëveshjet me institucionet e huaja me qëllim të rrisë mundësitë e mobilitetit për stafin akademik, studentëve por edhe përfitimin e granteve dhe projekteve të ndryshme. Përmirësim duhet të ketë edhe plani mësimor me qëllim arritjen e standarteve europiane konkretisht përmirësim duhet të kenë pikat e mëposhtme:

- **Të riorganizohen lëndët në nivel moduli jo me sasi të lartë kreditesh, gjë që çon në penalizim të ecurisë së studimeve të studentëve në mobilitetin tyre.**
- **Koeficientët e përdorur për të konvertuar kreditet e secilës veprimtari mësimore në orë mësimore dhe raportet midis vetë veprimtarive formuese nuk janë respektuar sipas udhëzimeve përkatëse të MAS p.sh.**
- **Perqindejt e disiplinave si:**
 - Lëndët me zgjedhje janë në përqindje të ulët rreth 4 kredite, nga 20-24 kredite që është kriteri ligjor.
 - Tema e diplomes është diku 10 kredite dhe diku 15 kredite, por jashtëlimiteve referuar udhëzimit përkatës (rreth 20-30 kredite)
- **Shpërndarja e lëndëve sipas tipologjisë A, B, C, D, E, F, shpesh është e pasaktë dhe në dokumentacione të ndryshme nuk është konsistente.**
- **Nuk pasqyrohet ngarkesa mësimore vjetore dhe ajo javore për studentin në planin mësimor.**
- **Në planin mësimor nuk ka të evidentuar aktivitetet mësimore në formën e projekteve.**
- **Në vitin e tretë, të katërt dhe të pestë në planin mësimor të rishikuar në vitin akademik 2016-2017 leksionet të llogaritura në % përbëjnë më pak se 50% të totalit (kriteri ligjor 50-85%, Udhëzimi 15, Dt. 4.4.2008).**
- **Të rishihet rregullorja e ekuivalnetimeve dhe transferimeve. Në shembujt e shqyrtuar gjatë vizitës u kostatua se procesi i ekuivalntimit dhe transferimit bëhej në bazë të një procedure të përcaktuar, ku studenti regjistrohej pas vendimit të komisionit gjë që mendojmë se duhet bërë paraprakisht, si dhe kreditet e ekuivalentuara përbëjnë 75% të lëndës psh: Lënda Farmakognozi e kryer nga studenti i transferuar nga 10 kredite është ekuivalentuar në 15 kredite jo në përputhje me nenin 14 të rregullores së programit të studimit**

Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin farmaceutik shqiptar dhe direktivat mbi profesionet e rregulluara.

	Terminologjia e përdorur për programin e studimit nuk është konseguente gjatë gjithë dokumentacionit të paraqitur.
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Bazuar në RBV, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” përfundon me vetëm 3 muaj praktikë profesionale, ndërkohë që standartet e shkollave europiane e kanë 5-6 muaj sepse në 20 kredite praktike profesionale duhen të shpërndahen në një ngarkesë me 8 orë në ditë gjë që nuk arrihet në kohën që institucioni ka lënë në dispozicion. (540 orë - 25 orëve = 21.6 jave)</p> <p>Për sa i përket Punimit të temës së Diplomës apo provimit përfundimtar ky program studimi i vlerëson me 10 ECTS, të cilat duhet të jenë rreth 30-40 ECTS;</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në Farmaci përputhet me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University” dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Bazuar në RBV, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se <i>personeli akademik efektiv që angazhohet në programin e studimit “Master i Shkencave” në Farmaci duhet të angazhohet më shumë në punën kërkimore shkencore jo vetëm për realizimin e programeve të studimeve po edhe për kualifikimin e tyre akademik;</i></p>
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Bazuar në RVB, dhe në vizitën në institucion dhe dokumentat shtesë të kërkuara në institucion, programi i studimit “Master i Shkencave” në Farmaci i ofruar nga “Albanian University” ka zhvilluar një studim mbi nevojat e tregut të punës në fushën farmaceutike. Nga ky studim ka rezultuar se tregu farmaceutik është i mbingopur, megjithatë ka mbetur degë e kërkuar dhe mbetet një program studimi i preferuar nga maturantët si rrjedhojë e ka vlerësuar si program studimi të vlefshëm për t’u vazhduar. Aktualisht frekuentohet nga 428 studentë per 2016-2017 (34 regjistruar për herë të parë në vitin e parë)</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” i ofruar nga Albanian University në bazë të RVB i shërben formimit të figurave profesionale të afta për të drejtuar sektorin farmaceutik, ndërkohë GVJ vlerëson se së pari duhet të synojë formimin e specialistëve të shëndetit me njohuri të thella farmaceutike në shërbim të pacientëve dhe të të gjithë popullatës. Megjithatë të dy objektivat nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen e vlerave kombëtare</p>

Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	Programi i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” i ofruar nga AU bën pjesë në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe përfundon me marrjen e diplomës “Master i Shkencave” në “Farmaci”. Realizohet me 300 kredite europiane ECTS të shpërndara në 5 vite akademike .
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Studentët informohen mbi programin e studimit në vitin e parë me takime direkte. Atyre iu jepet edhe një broshurë e programit mësimor 5-vjeçar. Informacioni mbi modulet e syllabuset iu jepet nga pedagogët e lëndës ditën e parë të mësimin. Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” që ofrohet nga AU informacioni mbi modulet dhe syllabuset komunikohen verbalisht. Programi i studimit iu jepet i në vitin e parë kur fillojnë studimet në AU.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Bazuar në RVB si dhe vizitës në institucion, GVJ vëren se Programi i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” deri në viti akademik 2015-2016 mbaron ose me provim formimi ose me temë diplome në bazë të mesatares së studimeve. Diplomimi me temë diplome është detyrim ligjor me kuadrin ligjor në fuqi specifikohet në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore por nuk ka një rregullore të veçantë. Institucioni ende nuk ka filluar të diplomojë studentët me temë diplome , madje për herë të parë ka filluar në 2015-2016 sipas raportit vjetor të vitit akademik 2015-2016. Edhe për vitin akademik 2016-2017 nuk janë miratuar për të gjithë studentët temat e diplomes por vetëm për 5 prej tyre. Në këte pikë diplomimi i studentëve është jo në përputhje me ligjin e arsimit të lartë nr 80/2015. Bazuar në RVB, dhe në vizitën e kryer në AU, bazuar në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në institucion dhe të dërguar prej tij në rrugë zyrtare pranë ASCAL për realizimin e programit të studimit “Master i Shkencave” “Farmaci” janë parashikuar 10 ECTS nga 30-40 kredite që duhet vlerësuar në bazë të standarteve.




Konkluzionet e vlerësimit:

- Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” ofrohet në përputhje me misionin dhe strategjinë e Universitetit. Programi i studimit “Master i Shkencave” në Farmaci është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin farmaceutik shqiptar dhe direktivat mbi profesionet e rregulluara.
- Institucioni kryen studim tregu por edhe pse konkludon se tregu i punës është i mbingopur nuk e reflekton në kuotat e pranimit.
- *Programi i studimit akoma nuk finalizohet me temë diplome* për të gjithë studentët edhe pse është detyrim ligjor, gjithashtu sasia e krediteve është e ulët (10 kredite në vend të rreth 30 kredite) në krahasim me nomrat e kërkuara nga udhëzimi i MASH përkatës. Programi përfshin në sasinë e duhur praktikën profesionale.
- Literatura ofrohet në gjuhën shqipe, *por numri i kopjeve në bibliotekë duhet rritur* se në shumicën e rasteve është 1, 2-3 kopje për tekst. Studentët informohen si në hyrje në lidhje me programin e studimit për Farmaci, edhe lëndë pas lënde në lidhje me syllabuset.
- Bazuar në të dhënat e përfshira në RVB, bazuar në vizitën në institucion si dhe në takimin e drejtpërdrejtë me pedagogët, GVJ vlerëson se *duhet të përmirësohet raporti PAE/PAK* gjë që do t'i shërbejë rritjes së cilësisë së mësimdhënies. *PAE duhet të profilizohet në lëndë specifike* dhe të zbatohet Udhëzimi Nr. 20 mbi ngarkesën e pedagogëve me kohë të plotë.
- GVJ vëren se nga ndryshimet e bëra në kurrikulën e Programin e Studimit është plotësuar kriteri në lidhje me realizimin e 70% të ngarkesës së programit të studimit nga PAE dhe 30% nga PAK. Nga ana tjetër ka ende vend për përmirësim sic janë:
 - shikojmë numrin e PAE, ai përbën më pak se 50% të tij.
 - Koeficientet e zbatuar për kreditet e lëndëve, GVJ vëren se nuk është zbatuar kriteri për verpimtarinë semianr, laborator si dhe një sër kriteresh të tjera.
 - Përqindjet e disiplinave dhe shpërndarja e lëndëve në to
 - Kohëzgjatja e praktikës profesionale duhet më e gjatë në përputhje me kreditet që ka
 - Procesi i transferimit dhe ekuivalentimit duhet të rregullohet me rregullore të qarta nuk është zbatuar gjithmonë neni 14 i rregullorers së programit të studimit.
 - Planet mësimore janë jo të miratuara edhe nga Rektori

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Bazuar në RVB, dhe vizitën në institucion si dhe dokumentacionin shtesë të dorëzuar GVJ vëren se mësimdhënia në Programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është e organizuar në leksione, seminare, laboratore, praktika, detyra kursi, provime semestrale, provime kursi, provim formimi, temë diplome. Mungojnë projektet në planin mësimor. Aktiviteti i mësimdhënies pasqyrohet në regjistrat e grupeve përkatëse që plotësohen nga PAE dhe PAK dhe ruhet nga sekretaria mësimore. Studentët e një kursi ndahen në nëngrupe laborator ose seminari në zbatim të Udhëzimit të MAS dhe shfrytëzohen ambientet përkatëse të siguruara nga AU. Kontrolli injohurive bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëvjete. Aktivizimi i studentëve në aktivitetet e njësisë duhet të rritet.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Format e mësimdhënies kombinohen në formën e leksioneve, seminareve laboratorëve dhe praktika profesionale. Leksionet e laboratorët përbëjnë përqindjen më të madhe të totalit të ngarkesës mësimore (2283 kundrejt 1477 seminare e praktikë profesionale). *Duhet të shtohen projektet në format e mësimdhënies së paraqitur në planin mësimor.*

Format e kontrollit të njohurive

Bazuar në RVB, dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion format e kontrollit të mësimdhënies kombinohen në kontroll të vazhdueshëm dhe provim kursi. Kontrolli i vazhdueshëm vlerësohet me 20%, frekuentimi vlerësohet me 10% dhe plotësimi i detyrimeve në laborator apo detyra kursi vlerësohet 10%, ndërsa provimi i kursit 60%.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Bazuar në RVB studentët angazhohen kryesisht në punimet shkencore të pedagogëve të veçantë apo nivel Departamenti. Nga gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se studentët angazhohen kryesisht në punime shkencore për Konferencën studentore. *Duhet rritur përqindja e studentëve që angazhohen në aktivitetin e Departamentit të Farmacisë si dhe në komisione të ndryshme.*

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Farmaci" të ofruar nga Albanian University pranohen në këtë program mbasi kanë përmbushur kriteret e pranimit të përcaktuara me ligj. Ata duhet të zotërojnë një diplomë të maturës dhe mesataren sipas përcaktimit nga MAS. Nuk rezulton te kete një kriter mesatare nga vetë institucioni deri në momentin para daljes së VKM nr 407 1.06.2016 për vendosjen e notës mesatare si kriter i hyrjes së studentëve në Universitet.

Bazuar në RVB studentët e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" japin deri në diplomim provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare në nivel B₁. GVJ vëren se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Farmaci" informohen mbi përmbajtjen e këtij programi qysh në fillim të vitit të parë.

Studenti i sapodiplomuar firmos për tërheqjen e diplomës, siç kërkohet në Udhëzimin e MAS nr. 31, datë 16.09.2014 duke shënuar emër, mbiemër, datë dhe firmë, aspekt që nuk është ndjekur në mënyrë rigorozë. Ka raste kur nuk është shkruar emri i plotë. Gjithashtu u konstatua se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Farmaci" informohen mbi rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit, e marrin duke shkuar direkt në sekretarinë mësimore, gjë që nuk ishte shumë e volitshme për ta.

Ndryshe nga sa thuhet në RVB, gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se është Departamenti i Farmacisë në bashkëpunim me Urdherin e Farmacisteve të Shqipërisë që ndihmon studentët e këtij programi të përzgjedhin institucionin në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale dhe jo Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët. Komunikimi i institucionit me Urdhërin e Farmacistit nuk është i formes zyrtare ,gjë që duhet të forcohet në mnyrë që studentët të jenë më të informuar dhe

studentët e programit në fjalë. Duhet të zhvillohet sistemi i tutoriatit në mënyrë që zëri i studentëve të jetë më i formalizuar e cila do ndihmojë në zgjidhjen e problematikave të hasura prej tyre gjatë procesit mësimor. Sipas RVB në tabelën me nr. 16 thuhet se 9 studentë kanë përfituar nga mobiliteti mes IAL-ve, ndërkohë që gjatë vizitës GVJ u informua se ishin vetëm 2 studentë të përzgjedhur nga ky program studimi, të cilët edhe këta nuk e kishin shfrytëzuar. GVJ vëren se sekretaria mësimore ka të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentëve hap pas hapi deri në diplomim, në lidhje me frekuentimin e tyre. Zyra e Këshillimit dhe Marrëdhënieve me Studentët ka një kalendar aktivitetesh vjetore që zhvillon për informimin e studentëve si dhe mban komunikimin me ish-studentët e diplomuar.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” të ofruar nga Albanian University pranohen në këtë program mbasi kanë përmbushur kriteret e pranimit të përcaktuara me ligj. Ata duhet të zotërojnë një diplomë të maturës shtetërore. Dy vitet e fundit akademik janë në përputhje me udhëzimet përkatëse të MASH në lidhje me aplikimin dhe regjistrimin e studentëve, Më parë nuk figuron të ketë pasur kriteret pranimi specifike për këtë program studimi.

Numri i studentëve të regjistruar për këtë program studimi nga viti 2010-2017 paraqitet në tabelën e mëposhtme

Nr	Vitet Akademike	Numri i studenteve të regjistruar per here te pare	Studente te transferuar sipas viteve					Transferime Total	Totali për vit akademik
			Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V		
1	2010-2011	95		4	4			8	103
2	2011-2012	125		6	7			13	138
3	2012-2013	88		4	6	2		12	100
4	2013-2014	93		9	7	2	1	19	112
5	2014-2015	87		29	60	97	144	330	417
6	2015-2016	66		5	3		17	25	91
7	2016-2017	51		9	3		9	21	72
8	2017-2018	34	3	5	3	1	8	20	54
	Totali	639						448	1087

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në përgjithësi bazuar në RVB nota mesatare e studentëve në hyrje është mbi 7, dhe vihet re se kjo mbetet e tillë edhe në dalje me oshilacione të parëndësishme. (Tabela 18)

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nga viti 2010 deri në vitin 2015 ka patur 77 studentë të transferuar dhe 330 të ardhur në vitin 2014 me mbylljen e disa IAL-ve nga MAS Ndërkohë ka vetëm 2 raste të mobilitetit të studentëve në kuadër të projekteve të cilat nuk janë relizuar. (Tabela 19, 20)

☑ Të dhëna për punësimin e studentëve

Këto të dhëna merren kryesisht nga urdheri i farmacisë me të cilin nuk ka komunikim zyrtar përvec momentit të vizitës, dhe nga kontakti i drejtpërdrejtë me ish-studentët nga strukturat e këtij institucioni. Nga 96 studentë të diplomuar në sezonin e verës të vitit 2017, janë punësuar 69 prej tyre që përbëjnë rreth 71%.

☑ Numri total të diplomuarve

Sipas RVB, vihet re se numri i të diplomuarve është 50-70%, ndërkohë që kalueshmëria nga viti në vit është rreth 95%. Bie në sy viti 2016 kur nga 261 studentë që kanë mbaruar vitin e 5-të të studimeve janë diplomuar 194, pra 74%. Në përgjithësi vihet re një kalueshmëri e lartë në lëndë edhe më të vështira. (Tabela 19, 20)

☑ Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Të dhënat e përfshira në RVB pasqyrojnë vetëm të diplomuarit në vitin 2016-2017. Nuk ka të dhëna për punësimin e të diplomuarve të mëparshëm.

☑ Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Nuk ka të dhëna

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriteve të pranimit.</p>	<p>Studentët që ndjekin programin e studimeve “Master i Shkencave” në “Farmaci” zotërojnë së paku diplomën e maturës;</p> <p>Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi si dhe udhëzimeve përkatëse për cdo vit akademik.</p> <p>Qysh nga viti akademik 2010-2011 studentët që dëshirojnë të ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci” duhet të kenë diplomën e maturës, por gjithashtu duhet të mbrojnë gjuhën angleze para diplomimit të tyre.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit nuk është specifikuar për pranimit të studentëve kriteri i notës mesatare.</p> <p>Bazuar në RVB studentët e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” japin deri në diplomim provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare në nivel B1 ndërkohë që për këto</p>

	<p>programe sipas standarteve në Kuadrin European të Gjuhëve niveli i kërkuar i gjuhës angleze është C1;</p> <p>Institucioni “Albanian University” vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit specifike.</p>
--	---

Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në Institucion studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci”.</p> <p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në AU studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci”, për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion qysh në fillim të vitit të parë të studimeve;</p> <p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se pranë AU funksionon Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët. Kjo zyrë ka si objektiv të punës së saj orientimin e studentëve që do diplomohen, në lidhje me tregun e punës, si dhe mbajtjen e statistikave të punësimit. Gjithashtu mban kontaktet të vazhdueshme me ish-studentët pas diplomimit të tyre.</p>
---	--

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se sekretaria mësimore e institucionit mban regjistra të rregullt me listën e dorëzimit të diplomave, suplementit dhe listës përfundimtare të notave. Studenti i sapodiplomuar firmos për tërheqjen e diplomës, por vërehet se në disa raste nuk është shënuar emër mbiemër si duhet;</p> <p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se sekretaria mësimore e AU ka statistika të rregullta vjetore, për numrin e studentëve tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo</p>
--	--

	<p>mospërfundimin me sukses të vitit akademik; të regjistruar në programin e studimit Nga viti 2010 deri në vitin 2017 janë regjistruar në total bashkë me transferimet 1087 studentë. Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se sekretaria mësimore e AU disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Sekretaria duhet të zbatojë udhëzimet në fuqi në lidhje me shënimet dhe procedurat e fletëve të pavlefshme të regjistrave themeltarë dhe atij të notave.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se Departamenti i Farmacisë ka filluar të mbajë të dhëna mbi punësimin e studentëve që diplomohen në programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci” në bashkëpunim me UFSH Bazuar në RVB, Albanian University po punon për realizimin e një baze të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve si dhe për vendet e tyre të punësimit.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” informohen mbi programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit nga Departamenti i Farmacisë, sekretaria mësimore si dhe Zyra e Këshillimit të karrierës dhe mbështetjes së studentëve. Tutoriati me pedagogë nuk funksionon si duhet pasi është caktuar vetëm 1 pedagog nga Departamenti për të gjithë studentët e këtij programi; GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” mund të informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit nga sekretaria mësimore. Ndërkohë me kërkesë të studentëve po punohet për ngritjen e sekretarisë online në mënyrë që ky informacion të jetë sa më lehtë i aksesueshëm prej tyre;</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Tutoriati nuk funksionon si duhet pasi është caktuar vetëm 1 pedagog nga Departamenti për të gjithë studentët e këtij programi duke mos pasur mundësi që të asistojnë studentët gjatë vështirësive të procesit mësimor.

ZSBC me zhvillimin e pyetësorëve bën të mundur dëgjimin e zërit të studentëve në lidhje me procesin mësimor.

Bazuar në RVB dhe gjatë vizitës në institucion, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët ka si objektiv të punës së saj orientimin e studentëve që do diplomohen, në lidhje me tregun e punës, si dhe mbajtjen e statistikave të punësimit. Bazuar në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se është Departamenti i Farmacisë në bashkëpunim me UFSH që ndihmon studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Farmaci" në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.

Konkluzionet e vlerësimit:

- GVJ konstaton se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Farmaci" informohen mbi përmbajtjen e këtij programi që në fillim të vitit të parë. Më pas pedagogët përkatës informojnë studentët në lidhje me syllabuset, frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të lëndëve apo moduleve përkatëse.
- Në rregulloren e programit të studimit nuk është specifikuar për praninë e studentëve kriteri i notës mesatare, ndërkohe që është detyrim ligjor bazuar në vkm 407 dt. 01.06.2016. Aplikohet kriteri i gjuhës angleze.
- GVJ vëren se sekretaria mësimore e institucionit mban regjistra me listën e dorëzimit të diplomave, suplementit dhe listës përfundimtare të notave. Studenti i sapodiplomuar firmos për tërheqjen e diplomës, por vërehet se në disa raste nuk është shënuar emër mbiemër si duhet. Sekretaria duhet të zbatojë udhëzimet në fuqi në lidhje me shënimet dhe procedurat e fletëve të pavlefshme të regjistrave themelatre dhe atij të notave. GVJ vlerëson se puna për ngritjen e sekretarisë online, do ta bëjë më lehtë dhe të aksesueshëm për studentët e programit të studimit .
- Ndryshe nga sa thuhet në RVB, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se është Departamenti i Farmacisë në bashkëpunim me UFSH që ndihmon studentët e programit të studimit Master i Shkencave "Farmaci" në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale dhe jo Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët, pavarësisht se studentët mund të këshillohen apo informohen për problematika të ndryshme nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët, sekretaria mësimore.
- GVJ thekson se mbetet i domosdoshëm përmirësimi i funksionimit të tutoriatit pedagog/student, që sot është një pedagog për të gjithë studentët e programit në fjalë. Në RVB se 9 studentë kanë përfituar nga mobiliteti mes IAL-ve, ndërkohe që gjatë vizitës GVJ u informua se ishin vetëm 2 të përzgjedhur nga ky program studimi, të cilët edhe këta nuk e kishin shfrytëzuar.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Nuk mund të kuptohet aktiviteti akademik pa kërkimin shkencor. Mund të thuhet se është pikërisht kërkimi shkencor që transformon vlerat e formimit akademik në vlera konkrete për shoqërinë, kombinim e më gjerë. Kërkimi shkencor është shumë i rëndësishëm edhe për rritjen profesionale të vetë stafit akademik. Prandaj është e kuptueshme që politikat e kërkimit shkencor të jenë pjesë e rëndësishme e strategjisë së një Institucioni të Arsimit të Lartë siç është edhe Albanian University. Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në AU, GVJ vlerëson se në programin e studimit Master i Shkencave "Farmaci" aktiviteti kërkimor shkencor i është lënë në dorë iniciativës personale të stafit akademik të tij. Mbështetja në këtë fushë ka qenë e limituar në organizimin e Konferencave Farmaceutike të AU, në ofrimin pa pagesë për PAE të mundësisë së botimit në revistën e AU "Optime" me ISSN 2220461X si dhe disa konferenca studentore ku në bashkëpunim me pedagogët përkatës studentët kanë paraqitur punimet e tyre sic është konferenca Colomb. Nuk ka praktika të mobilitetit të stafit akademik me qëllim kualifikimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Gjatë vitit 2016-2017 personeli akademik me kohë të plotë i Departamentit të Farmacisë prej 30 anëtarësh ka publikuar 28 botime. (shih Tabela 15)

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Gjatë vitit 2016-2017 personeli akademik me kohë të plotë i departamentit të farmacisë ka marrë pjesë në 2 projekteve kërkimore fituese (shih Tabela 16, 17)

Numri i projekteve të zbatuara

Gjatë vitit 2016-2017 personeli akademik me kohë të plotë i departamentit të farmacisë ka zbatuar 2 projekteve kërkimore. shih Tabela 16, 17)

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Nga IAL janë organizuar 5 aktiviteteve shkencore

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL

Në këto aktivitete shkencore kanë marrë pjesë 85 individë.

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Gjatë vitit 2016-2017 janë zhvilluar 2 kërkime shkencore të lidhura me procesin mësimor.

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Nga pedagogët janë përfshirë në kërkime shkencore individuale 34 studentë.



Numri i Çmimeve Kombëtare

Nuk ka

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e	Bazuar në RVB, GVJ vëren se personeli akademik me kohë të plotë i përbërë nga 30 anëtarë dhe ka publikuar për vitin akademik 2016-2017, rreth 28 botime

shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Bazuar në të dhënat e paraqitura në RVB, GVJ vëren se stafi akademik efektiv programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci”, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e sektorit farmaceutik. Gjithsesi po të shohim numrin e stafit akademik, botimet dhe aktivitetin kërkimor shuhet të ishte me i lartë.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	Bazuar në takimet gjatë vizitë në institucion GVJ konstaton se mësimi zhvillohet i gjithi në gjuhën shqipe. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar mbas vizitës në institucion GVJ konstaton se Departamenti i Farmacisë ka 24 PAE nga të cilët 5 me PhD. Bazuar në gjetjet gjatë takimeve në Institucion, GVJ konstaton se nuk ka pedagogë që japin mësim në gjuhë të huaj .
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se Institucioni organizon programe për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik sidomos në fushën e mësimdhënies; Institucioni duhe të ofroje më shumë mundësi infrastrukture dhe financiare stafit akademik për të integruar në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se Institucioni mban një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi në trajtën e formularëve të performancës të plotëuar 2 herë në vit nga vetë PAE si dhe CV-të e përditësuara të tyre, të ruajtura në Departamentin e Farmacisë; Institucioni mban një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të dorëzuar pranë Bibliotekës së AU; Institucioni ka marrë pjesë dhe ka zbatuar 2 projekte kërkimore shkencore. Institucioni ka një database mbi projektet shkencore.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se Universiteti Privat “Albanian University” e ka pjesë të strategjisë së tij zhvillimin dhe mbështetjen e kërkimit shkencor, por është ende në hapat e para.

GVJ vlerëson se në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” aktiviteti kërkimor shkencor i është lënë në dorë iniciativës personale të stafit akademik të tij. Mbështetja në këtë fushë ka qenë e limituar në organizimin e Konferencave Farmaceutike të AU, në ofrimin pa pagesë për PAE të mundësisë së botimit në revistën e AU “Optime” me ISSN 2220461X.

Institucioni duhet të ofrojë më shumë mundësi infrastrukture dhe financiare të stafit akademik për të integruar në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit. Duhet të rrisë dhe të zhvillojë politikën mbështetëse për stafin akademik me qëllim rritjen e kërkimit shkencor, publikimve dhe mobilitetit ndërkombëtar.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Bazuar në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vlerëson se për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” në “Farmaci” institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike, por që duhen rinovuar çdo vit si QSUT, FSDKSH (me këtë fundit nuk kemi të dhëna për marrveshje të nënshkruara). Duhet përmirësuar bashkëpunimi me institucione private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit. GVJ konstatoi se Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi në nivel të ulët me institucionet homologe jashtë vendit për realizimin e objektivave të programeve të studimeve, por këto nuk duhet të mbeten të njëanshme. Në kuadrin e shkëmbimeve të stafit akademik duhet të rritet numri i stafit akademik që të shkojnë në institucionet homologe, jo vetëm e kundërta.

Institucioni bashkëpunon me subjektet farmaceutike të rrejtit të hapur për reialimin e praktikës profesionale. Gjithsesi duhet të rritet dhe përfordhet lidhja me komunitetin e biznesit dhe tregun e punës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

- **AU ka marrë pjesë si partner në 2 projekte Kombëtare apo ndërkombëtare**

Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ka qenë 2 gjatë vitit akademik 2016-2017 po për programin e doktoraturës jo të masterit.

- **Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit**

Nuk është trajnuar askush në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit

- **Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL**

Bazuar në RVB thuhet se janë 9 studentë që kanë përfituar nga mobiliteti nga dhe drejt IAL, bazuar në gjetjet gjatë vizitës në institucion kanë qenë vetëm 2 studentë të përzgjedhur në programin Erasmus, të cilët nuk e kanë shfrytëzuar këtë mundësi.

- **Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor**

Bazuar në RVB thuhet se janë 13 ambjente në funksion të kërkimit shkencor.

- **Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime**

Bazuar në RVB janë 21 pjesëmarrës në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime gjatë vitit akademik 2016-2017.(shih Tabela 16)

☑ **Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:**

- Ndër Institucionet qeveritare bashkëpunuese me AU dhe Departamentin e Farmacisë mund të përmenden QKEV në akreditimin e aktiviteteve, konferencave të edukimit në vazhdim.
- Organizatat Profesionale AU kane marreveshje institucionale me UFSH.
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Duhet përmirësuar bashkëpunimi me institucionet private farmaceutike dhe rrejtin farmaceutik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve Master i Shkencave në “Farmaci” institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike, por që duhen rinovuar çdo vit si QSUT, FSDKSH, etj. Nuk u vu re ndonjë evidencë bashkëpunimi me institucione private për kryerjen e praktikave të studentëve dhe që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e tyre.</p> <p>Për praktikën mësimore mbahet një librezë e cila plotësohet nga studenti dhe drejtuesi praktikës</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se ka një bashkëpunim dhe shkëmbim të vazhdueshëm të dhënash si brenda për brenda Departamentit të Farmacisë, ashtu edhe midis Departamentit, Dekanatit e Rektoratit dhe gjithë zyrave të tjera të administratës, në shërbim të hartimit dhe mbikëqyrjes së programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci”;</p> <p>Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se ka një ndarje detyrash mes personelit brenda institucionit, por ka edhe mbivendosije si në rastin e personelit të Zyrës së kurrikulave dhe ZSBC. Duhet marrë masa për ndarjen e tyre në mënyrë që të marrë secili përgjegjësitë respektive dhe të garantohet një marrëdhënie më e frytshme bashkëpunimi.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në RVB Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Institucionet homologe jashtë vendit në mbështetje të shkëmbimeve të eksperiencës akademike, por bazuar në takimet e kryera gjatë vizitës në institucion deri më sot nuk ka asnjë rast të stafit akademik efektiv nga Departamenti i Farmacisë, që të ketë shkuar në një nga këto institucione në kuadrin e shkëmbimit të stafëve akademike.</p> <p>Bazuar në RVB, dhe në takimet e kryera gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se AU ka marrëdhënie institucionale me UFSH dhe lidh marrëveshje bashkëpunimi, rast pas rasti, me punëdhënësit privatë për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës së studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në“Farmaci”;</p> <p>GVJ konstatoi se institucioni dhe Departamenti i Farmacisë organizojnë aktivitete, konferenca të akredituara pranë QKEV që i shërbejnë ngritjes së mëtejshme profesionale të farmacistëve;</p> <p>Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve dhe nxjerr detyrat për të ardhmen.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Si konkluzion bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vlerëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucioni për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike, por që duhen rinovuar çdo vit si QSUT, FSDKSH, etj. • Duhet përmirësuar bashkëpunimi me institucione private si ato prodhuese apo kontrolluese të sektorit farmaceutik për të patur një përgatitje profesionale sa më të mirë të studentëve, në të gjitha aspektet e këtij profesioni. • GVJ konstaton se ka komunikim të brendshëm të përvaktuar qartë në statut dhe rregullore. Nga ana tjetër mbivendosja e personelit si në rastin e Zyrës së kurrikulave dhe ZSBC bëjnë që të krijohet konfuzion dhe mosmarrje përgjegjësish. Duhet marrë masa për ndarjen e tyre në mënyrë që të marrë secili përgjegjësitë respektive dhe të garantohet një marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. • GVJ e vlerëson përpjekjen e Institucionit për të patur sa më shumë marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit për realizimin e objektivave të programeve të studimeve, por këto nuk duhet të mbeten të njëanshme. Duhet të punohet, që edhe personeli akademik shqiptar të ketë eksperiencën e tij jashtë, ashtu siç profesorët e huaj vijnë tek AU; • Institucioni duhet të rrisë marrëveshjet dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit të sistematik farmaceutik. 	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në Institucion vlerësojmë që Universiteti Privat “Albanian University ” është angazhuar për t’i plotësuar rekomandimet e lëna nga KA me VKA nr. 91, datë 03.09.2010 për programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci”. Mund të thuhet se:

Rekomandimi për ndryshimin e emërimit të Fakultetit **është plotësuar**. Tashmë quhet Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Rekomandimi mbi rritjen e ngarkesës mësimore të mbuluar nga pedagogët e brendshëm si dhe kualifikimin shkencor në përputhje edhe me orientimet e MASH **është plotësuar pjesërisht**.

Rekomandimi “Rishikimin e ngarkesës për lëndët e formimit bazë të planit mësimor, duke e reduktuar numrin e krediteve dhe duke balancuar nga ana tjetër me lëndët e kategorisë karakterizuese, **nuk është plotësuar**. Institucioni ka riklasifikuar lëndë të caktuara nga një kategori në tjetrën dhe ka akoma pasaktësi.

Rekomandimi mbi “Përmirësimin e veprimtarisë shkencore, strukturimi më i mirë i saj me një plan afatgjatë si dhe bashkëpunimin me institucionet jashtë Departamentit të Farmacisë së “Ufo University”, të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e kësaj veprimtarie, të shihet mundësia e angazhimit dhe të studentëve në punimet shkencore”, **plotëohet pjesërisht**.

Rekomandimi “Në përfundim të studimeve të parashikohet një tezë diplome me më shumë kredite se ato të parashikuara në këtë plan studimi për “përgatitjen e provimeve të diplomës” **nuk plotësohet**.

Rekomandimi “Të organizohet sa më shpejt përfaqësimi dhe organizimi i studentëve në organizmat studentore dhe organet akademike” **plotësohet pjesërisht**.

Si konkluzion nga 6 rekomandime të lëna **1 është plotësuar plotësisht, 3 janë plotësuar pjesërisht** ndërsa **2 nuk janë plotësuar** ende.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SËOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Institucioni ka infrastrukturën e përshtatshme për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit në Farmaci.
2. Sistemi i Laboratoreve është i plotë dhe funksional si dhe i pajisur me aparaturat dhe reagentët përkatës.
3. Institucioni kryen në mënyrë sistematike vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të ndryshme (në formën e sondazheve dhe pyetësorëve)
4. Institucioni përkujdeset për studentët si gjatë viteve që ata janë pjesë e tij, edhe kur ata mbarojnë studimet përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës.
5. Përzgjedhja e kandidatëve për programin e studimit është kryer në bazë të kritereve ligjore dy vitet e fundit.
6. Staf i administrativ është i përgatitur mirë dhe i gatshëm për të mbështetur menaxhimin e programit të studimit.

b. Pika të dobëta

1. Institucioni ka realizuar pjesërisht rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë. Puna për plotësimin e rekomandimeve ka filluar 5 vjet pas tij.
2. Nuk bëhen në përputhje me aktet normative si statuti dhe rregullorja e IAL-së procedurat e mëposhtme:
 - a) Struktura, përmbajtja dhe ndryshimet e programit të studimit dhe planit mësimor. Janë pakësuar kreditet e lëndëve profesionale.
 - b) Syllabuset janë të ndërtuara me rubrikat e duhura, por firmosen në shumicën e rasteve nga lektori dhe jo nga titullari. Një pjesë e titullarëve nuk kanë ngarkesë në lëndën përkatëse por vetëm në lëndë të tjera.
 - c) Shpërndarja e ngarkesës shpesh nuk bëhet në përputhje me profilin e pedagogut dhe nuk ka akte normative të brendshme për rregullimin e saj.
 - d) Rekrutimi i stafit bëhet me procedurë të ndryshme nga ajo që përshkruhet në statut dhe rregulloren e IAL-së.
 - e) Vlerësimi i krediteve të transferimit dhe ekuivalentimeve të studimeve
3. Institucioni nuk ka stabilitet të stafit akademik referuar 5 viteve të fundit akademike, gjë që çon në ruajtjen e vlerave dhe cilësisë së procesit mësimor dhe jetës akademike të tij. Për vitin akademik 2016-2017 dhe 2015-2016 plotësohet kriteri i i mbulimit e 70 % të ngarkesës nga staf me kohë të plotë, kurse kriteri i raportit PAE/PAK mbi 70% nuk plotësohet në asnjë vit akademik.
4. Shumica e studentëve ende nuk diplomohen me temë diplome por me provim edhe pse është detyrim aktual ligjor.
5. Studentët nuk kanë sistem tutoriat, i cili do të ndikonte pozitivisht në mbarëvajtjen e studentëve.
6. Të ardhurat e universitetit vijnë vetëm nga tarifat e shkollimit të studenteve.
7. Biblioteka duhet të përditësohet me literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit si dhe abonimet në bibliotekat online të jone me të drejta të plota.

c. Mundësitë:

1. Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në lidhje me organizmin e programit të studimit dhe planit mësimor do të sillte një raport optimal të PAE/PAK, ngarkesë mësimore më të vogël, kosto më të ulët dhe cilësi më të lartë të zhvillimit të procesit mësimor dhe formimit të studentit.
2. Krijimi i një kampusi universitar do të krijonte një infrastrukturë akoma më të përshtatshme dhe më cilësore për zhvillimin e programit të studimit.
3. Suksesi i programit të studimit do të katalizojë iniciativat e ardhshme në fushën farmaceutike si dhe ofrimin e ciklit të tretë në këtë fushë.
4. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan rol koordinues dhe vlerësues, por përbërja e saj nuk është e qëndrueshme.
5. Institucioni duhet të përmirësojë politikat mbështetëse dhe financiare për të rritur mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve.

d. Pengesat:

1. Planet mësimore janë pengesë për krijimin e një programi studimi cilësor në kohë për shkak të mospërputhjeve me aktet normative përkatëse.
2. Egziston rreziku financiar i programit të studimit vetëm nga tarifat e studentëve.
3. Stafit akademik në qoftë se vazhdon të mos mbështetet nga institucioni për kërkimin edhe mobilitetin rrezikon ulje dhe reduktim të nivelit akademik.
4. Marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të programit të Farmacisë janë të pakta.

II. SUMMARY ANALYSIS OF THE EER BY THE SWOT METHOD (STRENGTHS-WEAKNESSES- OPPORTUNITIES -THREATS).

a. Strong points:

1. The institution has the appropriate infrastructure for the realization and progress of the Pharmacy study program.
2. Laboratories infrastructure are functional and equipped with appropriate equipment and reagents.
3. The institution performs systematically the assessment of academic and administrative activity through various methods (in the form of surveys and questionnaires)
4. The institution cares for students during the years of studies and also after they complete their studies through the Career Counseling Office.
5. Selection criteria of candidates for the study program was conducted on the legal basis of criteria for the last two years.
6. The administrative staff is well prepared and ready to support the management of the study program.

b. Weak Points

1. The institution has partially implemented the recommendations left by the first accreditation. They have begun to complete the recommendations 5 years after the accreditation.

2. The following procedures are not in compliance with normative acts such as statute and HEI regulation

a) Program study design, content and changes of it. The credits of professional subjects are lower compare to the earlier study program.

b) The syllables are constructed with the appropriate elements, but in most cases are signed by the lecturer and not by the holder. Some of Subject holders have no working load on their subjects but in other ones.

c) The distribution of the working load in most cases is not in accordance with the profile of the lecturer and not even regulated with the internal normative acts.

d) Academic staff recruitment is done by a procedure other than the one prescribed by the statute and the regulation of HEI.

e) Evaluation of transfer credits and program study equivalents.

3. The institution does not have the stability of the academic staff referred to the last five academic years, which is in accordance with the values and quality of the teaching process and its academic life. For the academic year 2016-2017 and 2015-2016, the coverage criterion of 70% of full time staff coverage is met, while the criterion for the full time academic staff /part time academic staff report over 70% is not fulfilled in any academic year.

4. Most of the students are still not graduated with a diploma thesis but with a final exam although the current legal obligation.

5. Students still do not have a tutorial system, which would positively affect the student's performance.

6. University incomes are based only on student tuition fees.

7. The library should be enriched with basic literature and advised one of recent years as well as subscriptions to online libraries to be fully operated.

c. Options:

1. The implementation of legal and sub-legal acts related to the organization of the study program and the curriculum would bring in an optimal ratio of full time academic staff /part time academic staff, lower working load, lower cost and higher quality of development learning process and student formation.

2. A university campus would create an appropriate and qualitative infrastructure for the development of the study program

3. The success of the study program will catalyze future initiatives in the pharmaceutical field as well as the third cycle delivery in this field.

4. The Internal Quality Assurance Office plays a coordinating and evaluative role, but its composition should be more stable.

5. Institution should improve supportive and financial policies to increase the mobility of academic staff and students.

d. Threats

1. Study program plans are an obstacle to the creation of a quality study program over time due to non-compliance with relevant normative acts.

2. There is an obvious risk of funding the study program only from student fees.



3. If the academic staff is not supported for the research and mobility by the institution there is a risk of reducing the academic level.
4. The national and international agreements under the Pharmacy program are not sufficient.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Dr. Entela Haloci
2. Prof. As.Dr. Brunilda Myftari

Two handwritten signatures in blue ink are positioned to the right of the list of names. The top signature is more stylized and appears to be 'E. Haloci', while the bottom signature is more legible and appears to be 'B. Myftari'.